

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7714 E hënë 19 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



Lajmi që qeveria po mendon të ddyfishojë paketën e investimeve nëpërmjet formulës së Partneriteteve Publik-Privat (PPP-ve) nga një në dy miliardë euro ...
Vijon në faqen 19

Dyfshim investimesh apo dhjetëfishim problemesh?

Opinion Ditës

Nga PËRPARIM KABO



Umbushën 100 vite nga përfundimi Luftës së Parë Botërore. Faktet historike janë dëshmitë dhe statistikat gjithë po aq. Kur ajo mbaroi, ata që e çuan botën ...
Vijon në faqet 20-21

Mendimi në prag të 'Luftës së Madhe'...



INTERVISTA

Anëtari i Autoritetit të Dosjeve: Si po shkon procesi

Simon Miraka: Ja bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të në administratë

“Kthimi i eshtrave të Mit’hat Frashërit do të shërbejë edhe për një pajtim kombëtar”

Anëtari i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Simon Mirakaj vlerëson vendimin e qeverisë për të sjellë eshtrat e Mit’hat Frashërit, duke shprehur besimin se kjo do t’i shërbejë pajtimit kombëtar. Sipas tij, kushdo që mund të bëjë akuza ndaj figurës së tij, duhet t’i shoqërojë ato me fakte. Mirakaj ...
Në faqen 4

MINISTRI I FINANCAVE: PARATE QE NUK DO TE PERDOREN, TRASHEGOHEN VITIN PASARDHES

AHMETAJ: FONDI I PRONAVE, SI NDAHEN 40 MILIONE USD

“Çfarë kemi përcaktuar për pronarët, nuk do të preket. Shuma që ka parashikuar buxheti për 2019-n është 10 milionë dollarë më tepër se këtë vit”



(Në foto) Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

RAMA: DO TE STREHOHEN

Unaza e Re, banorët në ditën e 15 të protestës: Pronat i mbrojmë me gjak

Në faqen 2

DEKLARATA

Lulzim Basha, PS-së: Tri kushtet për t’i dhënë fund krizës politike në Kuvend

Në faqen 3

EMRAT DHE FOTOT

Nga vrasjet te dhuna, kush janë 22 të shumëkërkuarit e drejtësisë në Dibër

Në faqen 7

FLET ENTELA BINJAKU

Sociologia: Femrat e angazhuara në politikë, pre e ngacmimeve seksuale

Në faqet 8-9

IRAKLI KOÇOLLARI



Profili kompleks i Mit’hat Frashërit, në dokumentet gjermane e amerikane

Në faqet 10-11

Mjekja psikiatre: Dëshmitarët, policët, punonjësit e urgjencës e media, më të prekurit

Arjana Rreli: Si të menaxhoni stresin post-traumatik

Ylli Merja: Infeksionet e fytyrës, si t’i trajtoni me bimë medicinale

NGA VOLTIZA DURO

Mund të na ndodhë që të përfshihemi në ngjarje tronditëse, e madje edhe me pasojë fatale. Pas kësaj, jo të pak persona që kanë qenë dëshmitarë të ngjarjes dhe e kanë përjetuar atë, fillon të shfaqet stresi post-



traumatik. Në një intervistë për suplementin “Life Pages” në “Gazeta Shqiptare”, Arjana Rreli, mjeke psikiatre me një eksperiencë 30-vjeçare në këtë fushë, e cila prej 8 vitesh punon në Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor numër 3 në Tiranë tregon mbi ...

Suplement

PROTESTA UNAZA

Protestuesit kanë bllokuar dje Unazën dhe kanë paralajmëruar ngritjen e çadrave

Dita e 15-të e protestës, banorët: Pronat do t'i mbrojmë me gjak

"S'ka transparencë as nga qeveria, as nga bashkia"

Ka vijuar dje për 15 ditë me radhë protesta e banorëve të "Astirit", që preken nga zbatimi i projektit të zgjerimit të Unazës së Madhe. Ashtu siç edhe e kanë bërë normalitet tashmë, ata kanë dalë në protestë dje dy herë, gjatë orëve të paradites dhe më pas në mbrëmje. Të mbështetur edhe nga deputetët e opozitës Flamur Noka dhe Klevis Balliu, ata kanë protestuar kundër prishjes së ndërtimeve anës rrugës, pa u shpërblyer më parë sipas çmimeve të tregut, ndërsa kanë bllokuar dhe kalimin e automjeteve për disa orë. Banorët kanë deklaruar se nuk do lejojnë që ky projekt të nënsë zbatimin dhe se pronat e tyre do t'i mbrojnë me gjak.



PROJEKTI

Në total janë 317 ndërtime që do të preken nga projekti, shumica e tyre njësi tregtare. Një pjesë e tyre janë të legalizuara dhe përfitojnë shpronësim të plotë, ndërsa shumica nuk kanë mundur ta mbyllin procesin e legalizimit dhe sipas qeverisë, nuk përfitojnë nga shpronësimi.

"Do u paguhet qira tri vite nga taksat e shqiptarëve"

Rama: Askush s'do t'i lerë jashtë, por jo me shfaqje antizhvillim

Për situatën e krijuar në Unazën e Madhe për shkak të projektit të zgjerimit të saj, ka reaguar dje edhe kryeministri Edi Rama. Ai ka siguruar edhe një herë se askush nuk do të mbetet pa një strehë dhe se qeveria do të dëmshpërblejë të gjithë ata që i kanë ndërtimet e tyre me dokumente dhe për të gjithë të tjerët do të ofrojë bonus qiraje. Shfaqja e agresivitetit antizhvillim tek Unaza e Re është pasqyra e

mendësive të së shkuarës në rrupallë, s'ka asnjë lidhje me pasqyrën e qeverisjes! Nuk e di ku e ke dëgjuar ti këtë gjuhën kundër shpellarëve, me siguri nga kadrinjtë e kazanit të SHQUP-it, po zhvillimi i atij projekti s'ka asnjë lidhje me çfarë sheh ti në TV apo me sa i gatshëm je ti të presësh në trafik! Ndërkohë po të informoj se shumica dërrmuese aty s'janë shtëpi, po godina të paligjshme biznesesh, ndërsa për sa u takon familjeve, duhet ta mësosh që jo vetëm askush s'do t'i

lerë jashtë, po do u paguhet qira tri vjet nga taksat e shqiptarëve! Më shumë se kaq?", mbyll komentin e tij kryeministri Edi Rama, teksa i është përgjigjur një komentuesi në rrjetet sociale. Kreu i qeverisë ka bërë të ditur më parë se projekti i Unazës nuk do të ndalet dhe se qeveria do të ofrojë si zgjidhje shpronësim, siç e parashikon ligji për ata që i kanë ndërtimet me dokumente dhe bonus qiraje për tri vjet për ata që nuk i kanë legalizuar dot.

preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe që të mbështesin protestën e tyre. Ata kanë hedhur gjatë gjithë kohës shaska dhe tymuese, ndërsa kanë kërcënuar edhe një prej kompanive që ka marrë përsipër punimet në këtë segment se nëse nuk do të largohet, do t'i shkatërrojë makineritë. Gjithashtu, ata paralajmëruan se do të përkallëzohen veprimet e tyre

në rast se institucionet nuk reagojnë, duke vendosur çadra në rrugë. Protestuesit shprehën vendosmërinë për të mbrojtur shtëpitë e tyre derisa kompensimi për prishjen e objekteve të bëhet sipas vlerës së tregut. Marshimi i banorëve u shoqërua nga forca të shumta të policisë. Në total janë 317 ndërtime që do të preken nga projekti, shumica e tyre një-

si tregtare. Një pjesë e tyre janë të legalizuara dhe përfitojnë shpronësim të plotë, ndërsa shumica e tyre nuk kanë mundur ta mbyllin procesin e legalizimit dhe sipas qeverisë nuk përfitojnë nga shpronësimi. Për të qeveria ka ofruar një bonus qiraje për tri vite, si dhe trajtimin me prioritet në shpërndarjen e kredive të buta.



Gjatë protestës së banorëve të "Astirit"

SHKURT

PD: Po nxirren në rrugë 1 mijë familje, dëmshpërblim për të gjithë

Opozita ka këmbëngulur sërish dje se qeveria duhet t'i shpronësojë të gjithë banorët që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe me çmimin e tregut. Duke folur gjatë një takimi në Berat, kreu i PD-së, Lulzim Basha, ka akuzuar qeverinë se po kërkon të lërë pa strehim 1 mijë familje. "Më shumë se 1/3 e këtyre familjeve e kanë përfunduar procesin e legalizimit, pra janë pronarë me letra të shtëpive të tyre. Edhe ata të tjerët që janë në proces legalizimi, tash sa vjet zvarriten dyerve pa marrë asnjë përgjigje, janë dhënë një ditë të bukur para dy javësh, me shenja boje në muret dhe kolonat e shtëpive të tyre. I kanë shënuar, për t'ua prishur shtëpitë, atyre, 1 mijë e sa familjeve. Me qindra, me mijëra vogëlushë, vajza dhe djem të vegjël jetojnë të traumatizuar prej dy javësh sepse prindërit nuk e fshihin dot hallin e madh që i ka zënë", tha Basha. Ai tha se në asnjë vend të botës nuk kërcënohet një qytetar me prishjen e banesës pa i dhënë asnjë shpjegim, pa zbatuar ligjin dhe pa i garantuar dëmshpërblim sipas ligjit me vlerën e tregut.

Protestuesit padisin Veliajn, policia devijon trafikun

Banorët e "Astirit" do të padisin sot kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj në prokurori për fyerje dhe mashtrim. Një përfaqësi e banorëve i janë drejtuar që dje Prokurorisë së Tiranës për të dorëzuar padinë, por kjo ka qenë e pamundur për shkak se ishte ditë pushimi. Ndërkohë që Policia Rrugore ka marrë masat për të devijuar qarkullimin e makinave gjatë kohës që banorët e "Astirit" protestojnë, në mënyrë që të shmangin përplasjet e mundshme. Kështu, për të gjitha makinat që vijnë nga autostrada Durrës-Tiranë dhe ato nga veriu kalimi gjatë kohës së protestës do të bëhet vetëm drejt, pra përgjatë rrugës "Dritan Hoxha" në drejtim të rrethorullimit të "Zogut të Zi".

REDAKSION: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Dossier: Iv Kaloçi, Redaktor i Rrethëve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli.

Art Designer: Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtori e Uzinës së Autokatorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel/Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazeteshqiptare@hotmail.com; redksia@gazeteshqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik" Shpk



Kreu i PD-së i ka caktuar PS-së tri kushtet për t'i dhënë fund krizës politike

Basha: Nuk ka kthim në Kuvend, pa pastruar politikën nga krimi

"Parlamenti, me politikanë të inkriminuar"

Përkundër thirrjeve të faktorit ndërkombëtar që lufta politike të bëhet në institucione, opozita është e vendosur që t'i shkojë deri në fund bojkotit të saj ndaj Kuvendit. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka konfirmuar dje nga Berati, gjatë një takimi me anëtarë të partisë, se nuk do ketë kthim në Kuvend nëse politika nuk pastron nga krimi. Ai u shpreh se një nga vijat e kuqe të opozitës për zgjidhjen e krizës politike është pikërisht pastrimi i politikës nga krimi. "E para dhe më kryesorja, e padiskutueshme, pa të cilën nuk mund të ketë rrugë përpara dhe me të cilën nuk mund të ketë asnjë lloj kompromisi, dua ta them qartë nga Berati dhe ta dëgjojë e gjithë Shqipëria. Asnjë lloj kompromisi pa pastruar parlamentin nga kriminelët e lidhur me krimin", tha Basha. Ai me këtë rast i ktheu përgjigje edhe faktorit ndërkombëtar, që kërkon rikthimin e opozitës në parlament se kjo do jetë e pamundur deri sa të ndahet politika nga krimi. "Kompromisi me krimin nuk mund të bëjmë, ndaj u bëj thirrje të gjithëve, edhe miqve tanë, që s'i kanë hapur sytë akoma, t'i hapin mirë. Kthim në parlament me politikanët e lidhur me krimin nuk ka dhe nuk do të ketë", shtoi Basha në fjalën e tij. Zgjidhja sipas tij për këtë është shumë e thjeshtë, mazhoranca të pranojë ligjin për vetingun e politikanëve dhe pastaj të vendosë ai se cili do duhet të qëndrojë në politikë dhe cili jo. "Zgjidhja është para jush. Tash tre muaj, në formën e amendamentit kushtetues, për pastrimin e politikës nga krimi. Nesër vjen një delegacion i Komisionit të Venecias, personalisht dua t'u them se janë munduar kot që kanë ardhur. Ne s'kërkojmë asgjë më shumë sesa standardi që ata miratuan për gjyqtarët dhe prokurorët. Që politikanët e lidhur me krimin të humbasin mandatet", theksoi kryetari i Partisë Demokratike. Pikërisht miratimin e vetingut, Basha e ka konsideruar si një tjetër vijë të kuqe, të cilën opozita nuk mund ta shkelë. "Trajtim preferencial për politikanët nuk do të ketë.



Basha gjatë takimit në Berat

VETINGU
"Trajtim preferencial për politikanët nuk do të ketë. Dita kur politikanët të mos jenë më mbi ligjin, do të jetë dita e parë e bardhë për qytetarët në Shqipëri. Nëse duan zgjidhje institucionale, kjo është zgjidhje institucionale. Miratimi i amendamentit kushtetues për vetingun e politikanëve".

SHKURT

Kryemadhi: Në zgjedhje, bashkë si opozitë kundër sektit të rilindjes

Ndërsa kreu i PD-së, Lulzim Basha përjashtoi çdo lloj zgjidhjeje të krizës pa pastruar politikën nga krimi, Lëvizja Socialiste për Integrim nga ana tjetër ka "ndezur motorët" për t'u bërë gati për zgjedhjet e ardhshme vendore. Nga Saranda ku mori pjesë në një takim me strukturat lokale të LSI-së, Monika Kryemadhi theksoi se opozita ka nisur tashmë përgatitjet për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 30 qershor. "Ne tashmë jemi në një front opozitar. Do të shkojmë drejt marrëveshjeve me të cilat do të hyjmë bashkërisht në zgjedhjet lokale, në përzgjedhjet e kandidatëve. Është jashtëzakonisht i domosdoshëm funksionimi dhe riorganizimi i strukturave tona si një bllok opozitar, kundër një të keqeje shumë të madhe, që është qeverisja e një sektit kriminal si Rilindja", deklaroi Kryemadhi nga Saranda. Ajo u shpreh gjithashtu se pa LSI-në nuk do ishte bërë e mundur lëvizja e shqiptarëve pa viza dhe marrja e statusit të vendit kandidat.

PD kërkon arrestimin e Vangjush Dakos

Partia Demokratike ka vijuar edhe dje të kërkojë me forcë dorëheqjen e kreu të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako. Deputeti i PD-së, Flamur Noka, në një konferencë të posaçme për mediat theksoi se dosja 339 që implikon kreun e Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, nuk mund të mbyllet, ndërsa akuzoi Ramën se mban peng arrestimin e kryebashkiakut të qytetit bregdetar. "Dosja 339 është prova e krimit elektoral të Vangjush Dakos, i cili bashkëpunoi me bandat për të blerë pushtetin ilegjitim të Edi Ramës. Në dosjen 339, të cilën Edi Rama po e mban të kyçur në sirtarët e Prokurorisë ekzistojnë me qindra faqe përgjime që provojnë se Vangjush Dako ishte në krye të operacionit kriminal për blerjen e votës në qarkun e Durrësit dhe kërcënimin të votuesve nëpërmjet bandave. Për këtë krim, kryetari i Bashkisë së Durrësit duhet të arrestohet", tha Noka.

"Jeni krenaria shqiptare e zonës së Manastirit"

Meta takon shqiptarët e Maqedonisë: Shteti shqiptar është pranë jush

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, pas vizitës në Manastir merastin e 110-vjetorit të Kongresit historik të Gjuhës Shqipe, vizitoi dje edhe fshatrat e banuara nga shqiptarët në Maqedoni, Mexhiti dhe Nakolec. Kreu i shtetit shqiptar, gjatë vizitës në fshatin me shumicë banorësh shqiptarë të Mexhilitis, u takua dhe bashkëbisedoi me autoritetet vendore dhe banorët e zonës, duke i garantuar ata për vëmendjen e shtetit shqiptar. "Shteti shqiptar do të qëndrojë gjithmonë pranë jush, sepse ju jeni krenaria shqiptare e zonës së Manastirit. Ju falënderoj që mbani gjallë e trashëgoni vlerat dhe traditat më të mira të shqiptarëve!", - i drejtua Presidenti Meta banorëve të fshatit, duke shtuar se "në historinë e kombit tonë Kruja, Prizreni, Manastiri dhe Vlora janë qytetet më të



rëndësishme për ne shqiptarët". Autoritetet vendore dhe banorët e zonës i shprehën mirënjohjen dhe falënderuan Presidentin e Republikës për vëmendjen dhe kujdesin e vazhdueshëm që tregon ndaj shqiptarëve në Maqedoni. Ndërsa në fshatin Nakolec, buzë liqenit të Prespës, Presidenti Meta u ndal në Teqenë "Dervish Ali", duke vënë në dukje se kjo është një vatrë e rëndësishme jo vetëm fetare, por edhe e ruajtjes së vlerave, traditave, gjuhës dhe identitetit tonë kombëtar. "Është kënaqësi e veçantë të vizitoj sot Nakolecin e Prespës dhe të ndodhem me vëllezërvë e motrave shqiptare, që po e mbajnë gjallë identitetin tonë kombëtar e gjuhën e mrekullueshme shqipe. Di-aspura shqiptare e Nakolecit asnjëherë nuk e ka harruar vendlindjen dhe kombin, duke dhënë kontribut të çmuar e të jashtëzakonshëm për ruajtjen e traditave tona kombëtare", - nënvizoi Presidenti i Republikës.

Dita kur politikanët të mos jenë më mbi ligjin, do të jetë dita e parë e bardhë për qytetarët në Shqipëri. Nëse duan zgjidhje institucionale, kjo është zgjidhje institucionale. Miratimi i amendamentit kushtetues për vetingun e politikanëve dhe shporrja një orë e më parë nga parlamenti dhe bashkitë e vendit dhe jashtë qdo institucioni, e politikanëve mafiozë, e politikanëve të lidhur me krimin", u shpreh Basha. Ai siguroi se opozita do i shkojë deri në fund kësaj

përpjekje dhe se të gjithë ata që kanë bërë pakt me kriminelët qoftë edhe për të blerë vota do të dalin përfundimisht nga institucionet dhe para ligjit. "Ta mendojnë mirë, ata që bëjnë pakte kriminale me votat, se i pret largimi nga institucionet dhe i pret burgu. Dhe ky është kushti i dytë, i panegociueshëm", theksoi kreu i opozitës. Një tjetër kusht për t'i dhënë fund krizës politike, sipas kreu të opozitës është edhe ndëshkimi i krimit elektoral. "Pa ndësh-

kuar krimin elektoral, pa ndëshkuar kryebashkiakët dhe ministrat nuk mund të ketë e nuk do të ketë kompromis as me opozitën, as me Partinë Demokratike. Do të ketë betejë të vendosur. Këta njerëz duhet të arrestohen. Dekriminalizimi i zgjedhjeve nis me ndëshkimin e krimit elektoral. Nuk ka për të pasur zgjidhje politike pa ndëshkimin e krimit elektoral të Edi Ramës dhe bashkëpunëtorëve të tij", nënvizoi Basha.

DOSJET INTERVISTA

Anëtari i Autoritetit të Dosjeve përshëndet kthimin e eshtrave të Mit'hat Frashërit

Miraka: Ju tregoj sa bashkëpunëtorë të Sigurimit ka në administratë

“Dëmshtëpërblimet, ka mungesë komunikimi”



Simon Miraka

Anëtari i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Simon Miraka vlerëson vendimin e qeverisë për të sjellë eshtrat e Mit'hat Frashërit, duke shprehur besimin se kjo do t'i shërbejë pajtimit kombëtar. Sipas tij, kushdo që mund të bëjë akuzë ndaj figurës së tij, duhet t'i shoqërojë ato me fakte. Mirakaj shprehet se ardhja e eshtrave të tij i bën nder Shqipërisë. Ish-drejtori i Përgjithshëm i Institutit të ish-të Përndjekurve Politikë, komenton gjithashtu edhe ecurinë e procesit të dëmshtëpërblimit, ndërsa bënë të ditur se reduktimi i fondit është një veprim i gabuar nga ana e qeverisë. Sa i përket procesit tjetër, atij të hapjes së dosjeve, ai shprehet se kemi të bëjmë me një proces të vështirë, ndërsa bënë të ditur se numri i zyrtarëve aktualë që kanë dosje të bashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit është i vogël. Kjo sipas tij, se shumica e zyrtarëve aktualë janë të rinj dhe nuk kanë qenë pjesë e administratës në kohën kur ka ekzistuar Sigurimi i Shtetit.

Kthimi i eshtrave të Mit'hat Frashërit është pasuar një debat i hapur, ku të majtë deklarojnë se po nderohen bashkëpunëtorët e fashizmit. Ju keni një koment për këtë çështje?

Unë e vlerësoj veprimin e qeverisë për kthimin e eshtrave të Mit'hat Frashërit, një figurë të madhe, që ka qenë edhe një antikomunist. Sigurisht që veteranerët e kanë kundërshtuar, ndërsa pjesa progresiste është ajo që nëpërmjet fondacionit "Lumo Skëndo", bëri kërkesën që u pranua nga qeveria, e cila mori vendimin për kthimin e eshtrave. Ne themi edhe me të drejtë që Greqia mban ende ligjin e luftës në skenë dhe ne kërkojmë me të drejtë që ligji i luftës të shfuqizohet se është e turpshme. Apo jo? Por, ndërsa kërkojmë të hiqet ligji i luftës nga Greqia, nga ana tjetër kërkojmë të mbajmë të ndezur luftën me njëri-tjetrin. Deri kur do të shkojmë kështu? Jemi në shekullin e XXI. Po të përmenjshëm fjalën e nobelistes sonë, Nënë Terezës, që thotë: "Ne i përkasim njëri-tjetrit". Duhet të përkulemi me respekt për gjithë ata që kanë rënë për çlirimin e vendit në luftë kundër pushtuesve nazifashistë. Kushdo duhet të përkulet, duhet të ketë respekt ndaj kujtimit të tyre. Por kjo nuk do të thotë të mos vlerësohen kontributet e Mit'hat Frashërit që vjen nga një derë që ka dhënë për këtë shtet, ka vënë mendjen dhe zemrën në shërbim të këtij shteti. Qoftë ai si person, qoftë edhe familjarët. Ai ishte i biri Abdyl Frashërit, kryetarit të Lidhjes së Prizrenit dhe është

të themeluesi i Kongresit të Manastirit, është firmëtar i pavarësisë. Pra, nuk duhet të kërkojmë një korrobace, siç thonë myzeqarët, në një oqean. Ne themi që vetëm Perëndia është e pagabueshme. Unë besoj që i ka bërë nder ardhja e eshtrave dhe mendoj që në njëfarë mënyrë do të shërbejë edhe për një pajtim kombëtar, i cili nuk po ndodh. Pra, prurja e këtyre eshtrave besoj se do ta luajë këtë rol.

Nisur nga kjo që thatë për çështjen e pajtimit kombëtar, dhe zëvendësimin e Mbrojtjes, Petro Koçi dhe Luan Rama e ka sulmuar këtë veprim dhe ka thënë që Balli Kombëtar duhet të kërkojë falje për bashkëpunimin me gjermanët dhe fashistët në përgjithësi...

Gjithmonë që të jesh i besueshëm duhet t'u referohesh fakteve historike se njëra palë thotë se kanë bashkëpunuar, kanë gjetur dokumente se ka bashkëpunuar Enver Hoxha me gjermanët, pala tjetër thotë ka bashkëpunuar Balli. Pra, e mira është që të paraqitemi me dokumente nëse ekzistojnë dokumente nëpër arkiva. Duhet marrë parasysh edhe rrethanat nëse është e vërtetë një bashkëpunim i tillë. Por unë kam dëgjuar historianët të cilët thonë, nuk ka një firmë nga Mid'hat Frashëri që të ketë dhënë urdhër për bashkëpunimin me gjermanët.

Deri tani nuk është gjetur një dokument. Pra, mendoj që duhen ulur gjakrat. Të gjithë kanë të drejtën që të pushojnë në vendin e vet dhe po e përsëris edhe njëherë, se ardhja e eshtrave të figurave si Mit'hat Frashërit veçse i bëjnë nder këtij vendi. Sigurisht ka kundërshtime për të, duhet respektuar edhe mendimi kundër, por "Në ç'vënd kemi lerë, ku na bëjnë nder, në Shqipëri", duhet t'i kujtojmë edhe thënie të të madhit Çajupi, kështu që Shqipëria është e të gjithëve pavarësisht këndvështrimeve të ndryshme që kemi me njëri-tjetrin, por Shqipëria është e jona.

Zoti Miraka, si po ecën procesi i dëmshtëpërblimit të të përndjekurve?

Ka përpjekje, kanë bërë një ndryshim që unë e kam quajtur pozitiv, që pasi iu dha përparësi të burgosurve që janë gjallë, tani flitet për kështin e tretë. Kanë dalë lista, emra, por ka një mungesë komunikimi me zyrat e sektorit të dëmshtëpërblimit. Shumë njerëz marrin në telefon, nuk gjejnë mënyrën se si të komunikojnë. Megjithatë, unë e quaj një hap pozitiv edhe ndryshimet e ligjit në favor të burgosurve që janë gjallë. Trashëgimtarët kanë mbetur një cikë më mbrapa në marrjen e dëmshtëpërblimit. Flitet për kështin e tretë, ka njerëz që nuk kanë marrë kështin e dytë, nuk kanë marrë as kështin e

parë. Nuk janë shumë sigurisht. Në kohën qeverisjes së Partisë Demokratike sektori i dëmshtëpërblimit ishte më vete dhe njerëzit të cilët nuk gjenin emrin nëpër lista e kishin shumë më të thjeshtë për të komunikuar sepse tashti sektori i dëmshtëpërblimit është në ministri dhe dihet se sa zor është që të hysh në ministri.

Ndërkohë që vitin e ardhshëm është parashikuar reduktimi i fondit për ish-të përndjekurit ...

Edhe kjo nuk është gjë e mirë sigurisht. Në kemi shprehur që të shtohet fondi, jo të pakësohet sepse edhe jeta nuk është 500 vjet. Puna është që njerëzit ta marrin dhe ta gëzojnë dëmshtëpërblimin që të kenë mundësi kur thonë, me mbajt filxhanin e kafes në dorë dhe jo atëherë kur të mos jenë të zotë me mbajt as kafën. E kam fjalën për të burgosurit që janë gjallë, po kështu edhe për trashëgimtarët, edhe ata tani janë nga 70-80 vjeç. Sigurisht nuk është e lehtë, sepse të kritikosh është gjëja më e lehtë. Sigurisht që ka vështirësi, sepse nuk jemi ndonjë shtet me ndonjë potencial të fuqishëm ekonomik. Kështu që pa një sakrificë nuk mund të arrihet që këta njerëz ta gëzojnë qoftë trashëgimtarët, qoftë ata të burgosur që janë gjallë.

A keni ju të dhëna sa janë të përndjekurit që kanë bërë

burg që janë ende gjallë?

Mund të jenë rreth 1500, nuk janë shumë, nuk besoj as aq.

Pse po ecën ngadalë hapja e dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit?

Kur flitej për hapjen e dosjeve, mendova që do ishte një gjë e thjeshtë, por nuk është e thjeshtë. Ka dy arsye sipas mendimit tim, është mungesa e infrastrukturës së nevojshme. Ne materialet i kemi në një vend tjetër, godinën e kemi në një vend tjetër, vetë jemi te Garda. Ka vështirësi të tilla, sepse ne jemi aprovuar nga parlamenti 60 dhe nuk jemi as 30. Kjo pastaj ka edhe vështirësi të veta sepse Sigurimi i Shtetit ka qenë një makineri tepër kriminale dhe ka vepruar në një mënyrë mjaft të sofistikuar. Megjithatë, ka përpjekje. Unë nuk jam nga ata që bëj komplimente kot, por stafi ekzistues, pavarësisht e kemi gjysma, gjithsej jep kontributin e vet aq sa mundet, aq sa i lejon ligji që të jemi sa më produktivë në punën tonë dhe të jemi sa më transparent, ky është qëllimi kryesor.

Sa dosje janë hapur që nga hyrja e ligjit në fuqi?

Ka një numër; por më ke gjetur të papërgatitur për të thënë numrin e saktë. Duhet të dish që çdo ditë ka individë, ka studiuës. Kemi dhënë një kontribut edhe në institucione me rastin e vetingut. Ka shumë institucione që kanë aplikuar për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë që emërohen.

Nisur nga kjo e fundit, sa zyrtarë kanë dalë me dosje?

Nuk kam shumë, për hir të së vërtetës janë shumë sepse shumica janë moshë e re dhe nuk i kap edhe ligji i pastërtisë.

Një numër të përafërt keni?

Nuk kam qejf me dhënë numër të pasaktë se pastaj nuk bëhesh i besueshëm.

Gjithsesi, ka pasur individë që kanë rezultuar me dosje ndërkohë që mbanin një pozicion shtetëror që është objekt i ligjit?

Në 1 mijë për shembull mund të ketë dalë 1. Nuk janë shumë për hir të së vërtetës.



Zbulohet varri masiv i të burgosurve politikë në Gjirokastrë

Zbulohen gjurmë të një varri masiv në Gjirokastrë. Bëhet fjalë për ekzistencën e një varri në këmbët e kështjellës së gytetit, aty ku janë pushkatuar, vrrarë dhe varrosur të dënuar politikë të diktaturës komuniste. Sipas portalit "JuguNews" varri masiv mendohej të jetë nga më të mëdhenjtë në vend, pasi janë propozur dhjetëra në mos qindra ish-të burgosur politikë, të cilët kanë vuajtur dënimet në ish-burgun famëkeq të Gjirokastrës në vitet 1944-1967 apo siç quhej rëndom në atë periudhë, tek "7 penxheret". Kryetari i Shoqatës Antikomuniste të Përndjekurve Politikë, Nebil Cika, ka bërë apel për vullnet politik, me qëllim fillimin sa më parë të punës për gjetjen e eshtrave të ish-të përndjekurve politikë, të ekzekutuar në burgun famëkeq të Gjirokastrës dhe propozur në një varr të vetëm masiv. Sipas tij, kjo varrezë u zbulua falë përpjekjeve individuale dhe me ndihmën e banorëve gjirokastritë kryesisht atyre që kanë jetuar në atë kohë dhe kanë parë se çfarë bëhej me të burgosurit politikë të periudhës së diktaturës.



Ahmetaj ka siguruar se fondi që nuk përdoret, do të trashëgohet për vitin pasardhës

Qeveria garanton fondin e pronave, ja si do të ndahen 40 mln USD

"Në 2019 do jenë 5 miliardë të nominuara që nuk preken"

Qeveria ka parashikuar që për vitin e ardhshëm të shtojë me afro 10 milionë dollarë fondin e kompensimit të pronave, më shumë se ishin parashikuar në 2018, duke e çuar shumën totale në afro 40 milionë dollarë ose 4.8 miliardë lekë të rinj. Kjo, me qëllim që të përmbushë objektivat e vëna në ligjin e kthimit dhe kompensimit të pronave, që i gjithë procesi të përfundojë brenda vitit 2025. Ndonëse një objektiv i vështirë për t'u arritur, kjo për shkak të problematikave të shumta që kanë lindur nga zbatimi i ligjit në praktikë, nga ana e qeverisë këtë vit është parashikuar një mekanizëm që do mundësojë që lekët të mos mungojnë. Kështu, për vitin 2019 është parashikuar që i gjithë fondi prej afro 40 milionë dollarë të jetë i garantuar për t'u përdorur vetëm për kompensim financiar të pronave. Kjo, pasi ky fond nuk do të digjet më në rast se nuk arrihet të përdoret, por do të trashëgohet për vitin pasardhës. Këtë e ka bërë të ditur ministri i Financave gjatë prezantimit të projekt buxhetit 2019 në Konferencën e Kryetarëve, ku theksoi se për herë të parë ky fond jo vetëm që vjen në një shifër të tillë gati të dyfishuar në raport me 4 vite më parë, por edhe se ai do të jetë i mbrojtur.



FONDI
"Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve parashikohet, siç e theksova më lart, në total në masën 5 miliardë lekë ose 0.3% e GDP-së. Duke filluar nga viti 2016, fondi i kompensimit është planifikuar në rritje nga viti në vit duke synuar në vitin 2021 shumën 5,5 miliardë lekë krahasuar me 1,89 miliardë lekë që ishte në vitin 2013".

"Materiali nga pala greke duhet të vinte në 25 gusht"

Procesi i integritimit, Greqia pengesë për plotësimin e detyrimeve

Shqipëria pret që në qershorin e ardhshëm të marrë një përgjigje pozitive sa i përket hapjes së negociatave për anëtarësim të plotë në Bashkimin Europian. Por, për të arritur këtë qëllim, Raporti i KE-së për Shqipërinë për vitin 2018, i lë vendit tonë një sërë rekomandimesh që duhen plotësuar para se të vij vlerësimi mbi progresin e bërë. Një prej institucioneve që i linden një sërë detyrash prej këtyre konkluzioneve është edhe institucioni i Kuvendit të Shqipërisë. Por edhe pse ka kaluar thuasje një vit nga dalja e Raportit të fundit të KE-së, Kuvendi i Shqipërisë nuk ka arritur ende të përmbushë disa nga detyrimet kryesore. Kjo jo vetëm si pasojë mosfunksionimit normal për shkak të bojkotit të opozitës, por edhe të faktorëve të tjerë që nuk kanë të bëjnë me gatishmërinë e Kuvendit për të plotësuar këto detyrime. Kështu, pengesë është bërë edhe Greqia, e cila nuk i është përmbajtur një marrëveshjeje të arritur me palën shqiptare për të hartuar manualin mbi përaftrimin dhe për ta sjellë në gjuhën shqipe dhe angleze. Ky shtetësim është ngritur nga Dedë Kasneci, drejtor i Shërbimit të Përaftrimit të Legjislacionit në Kuvendin e Shqipërisë, gjatë mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve të mbajtur në datën 30 tetor, në prani edhe të kryeparlamentarit Gramoz Ruci.

PROCESVERBALI

Vasilika Hysi - Tek Plani i Veprimit ka një 'footnote', ku flitet për projektin e binjakëzimit dhe është shënuar që raportit final i projektit do të dërgohej brenda datës 25 gusht dhe po brenda kësaj date ekspertët e projektit të binjakëzimit do të dërgonin edhe manualin në shqip dhe anglisht. Pvejtja ime është se a ka ardhur manuali brenda datës 25 gusht dhe raportit final i projektit a është përkthyer në gjuhën shqipe? Dedë Kasneci - Faleminderit zonja Hysi për pyetjet dhe mundësinë që më jepni për t'u sqaruar. Pala greke është angazhuar për të hartuar manualin mbi përaftrimin dhe për ta sjellë në gjuhën shqipe dhe angleze. Ato kanë sjellë vetëm 10 kopje, pra jo në përputhje me marrëveshjen që ishte bërë dhe pritet të sjellin edhe pjesën tjetër rreth 140 kopje të tjera në shqip dhe anglisht të manualit të përaftrimit. Lidhur me rrethimin e materialeve, përsëri ishin angazhuar pala greke që t'i dërgonin në të dy gjuhët, por nuk i kanë dërguar. Materiali i është dërguar OSBE-së për t'u përkthyer në gjuhën shqipe, pra dokumenti, gjatë dhe rekomandimet e projektit i është dërguar OSBE-së, e cila është angazhuar që ta përkthejë brenda muajit tetor. Presim dhe shpresojmë që ta dërgojmë brenda ditës së nesërme. Materiali është shumë voluminoz me mbi 130 faqe.

Vasili: Borxhi publik krim shtetëror, katastrofën e kemi te dera

Kryetari i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili bën përgjegjëse qeverinë për nivelin e ulët ekonomik në vend dhe thellimin e borxhit publik. Përmes një komenti në rrjetet sociale, Vasili shprehet ndër të tjera se kjo është nga arsyt kryesore të braktisjes së vendit, duke i krahasuar me emigrimet masive të viteve '90. "Shqipëria është mbërthyer qartazi në darënjë dhe një qeverisje, që krijon çdo çast ekonomi të asfiksuar dhe pa asnjë vizion, grabitje të financave publike dhe thellimin e një borxhi publik dërrmues. Ky falimentim i politikave ekonomike është edhe shkak themelor i braktisjes tragjike të vendit nga shqiptarët dhe rikthimi në këto dimensione i këtij fenomeni braktisjeje të vendit, të ngjashëm me atë të fund viteve '90, që është vërtet i frikshëm për të sotmen dhe të ardhmen", tha Vasili. Teksa vë në dukje fshehjen e borxhit publik, kreu i grupit parlamentar të LSI-së, ngre alarmin për situatën duke theksuar se katastrofën e kemi tek dera.



FONDI NË VITE

Viti 2019	-	4.860 miliardë lekë
Viti 2018	-	3.356 miliardë lekë
Viti 2017	-	2.029 miliardë lekë
Viti 2016	-	2.166 miliardë lekë

më lart në total në masën 5 miliardë lekë ose 0.3% e GDP-s. Duke filluar nga viti 2016 fondi i kompensimit është planifikuar në rritje nga viti në vit duke synuar në vitin 2021 shumën 5,5 miliardë lekë krahasuar me 1,89 miliardë lekë që ishte në vitin 2013. Rritja e fondit të kompensim-

it në vlerë të pronarëve bëhet në mbështetje të reformës së ndërmarrë nga kjo qeveri për trajtimin e ish-pronarëve, pjesë e së cilës është kompensimi në vlerë për t'u realizuar brenda periudhës 10-vjeçare të parashikuar edhe në ligjin nr.133 të vitit 2015. Për trajtimin e pronës dhe përfundi-

min e procesit të kompensimit", tha Ahmetaj. Gjithsesi, duhet theksuar se edhe për vitin 2018, fondi i kompensimit ishte afro 30 milionë dollarë, por vetëm një pjesë e vogël e tyre u arrit të shpërndahet, kjo pasi dosjet e përfunduara dhe që s'kanë ankimum apo pretendime nga palët janë shumë të pakta. Burime nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave bëjnë me dije se vetëm një pjesë e këtij fondi është mundur të ndahet për vitin ekzistues dhe kjo pikërisht për shkak të problemeve që kanë vendimet e dhëna nga më parë për kompensim.

KOMPENSIMI
Shuma që qeveria ka parashikuar për kompensimin financiar të ish-pronarëve është parashikuar që të vij me rritje vit pas viti. Kështu, në total ekzekutivi parashikon që deri në 2021 të ketë shpërndarë rreth 200 milionë dollarë, ndërsa në dokumentin makroekonomik fiskal për 3 vitet e ardhshme, fondi në adresë të pronarëve vjen në rritje. Nga rreth 30 milionë dollarë që ishte në 2018, fondi kalon 40 milionë dollarë në 2019 dhe për të shkuar në 55 milionë dollarë në 2021. Sipas ligjit në fuqi, Agjencia e Trajtitimit të Pronave kryen kompensimin financiar të subjektit pasi janë ezaturuar të gjitha mundësitë, në rastet, kur subjekti trajtohet me kompensim financiar. Trajtimi kryhet me këste të barabarta brenda 10 viteve, në përputhje me procedurat që miratohen me udhëzime të ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Gjithsesi, shifrat në rritje sërish janë të pamjaftueshme për të mbuluar faturet e kompensimit për 26 mijë vendime të formës së prerë që presin të ekzekutohen.

Investigimi i medias angleze: Të trafikuarit përdoren në rrugë, ndërsa pjesa tjetër në ruajtjen e plantacioneve të drogës

Bandat shqiptare shesin vajzat si prostituta

Trafiku i qenieve njerëzore nga Shqipëria në Britani rritet me 35 %

Trafiku i qenieve njerëzore për fat të keq vijon të ketë rritje vitet e fundit jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera, të cilat njihen për demokraci të konsoliduar. Ky fenomen duket se gjen shteg edhe në vendet më të zhvilluara se Shqipëria, pasi strukturat dhe aktiviteti i tyre drejtohet nga njerëz që kanë lidhje në të shumtën e herëve edhe me vetë strukturat ligjzbatuese, raporton "BalkanWeb". Televizioni prestigjioz britanik, "Sky News", i ka kushtuar një material të gjatë trafikut të qenieve njerëzore nga Shqipëria drejt Britanisë, ndërsa për këtë jep edhe shifra, të cilat duket se janë rritur me 35 për qind. Sipas investigimit të medias angleze, thuhet se shumica e të trafikuarve përdoren për prostitucion në rrugë, një pjesë tjetër përfundon në ruajtjen e plantacioneve të drogës, shpesh së saj e deri tek ushtrimi i punës në të zezë. Gazetari Dan White-



head dhe kolegët e tij të "Sky News" në funksion të këtij hulumtimi kanë vizituar edhe Shqipërinë, ndërsa shifrat e raportuara prej tyre janë konfirmuar edhe nga

Agjencia Kombëtare e Krimin në Angli apo enjohur ndryshe përmes akronimeve si (NCA). Gazetarët anglezë janë ndalur fillimisht në Vlorë, në një qendër ku ndod-

hen 15 femra, që kanë qenë viktime të trafikut dhe janë kthyer së fundmi nga Anglia. Këto femra janë torturuar barbarisht, janë goditur edhe pse ishin shtatzëna. Një nga

zërat për median britanike ishte Besjana, e cila tregoi se pasi kishte mbetur shtatzënë, familja, kryesisht vëllai dhe nëna i kishin bërë dalje, ndërsa kishin ushtruar dhunë, me qëllim që të dëshontë fëmijën. "Ata më rrahën që unë të humbisja foshnjën. Ishte vërtet keq, sepse unë mund ta humbja fëmijën në çdo moment", tha ajo për "Sky News". Agjencia Kombëtare e Krimin në Angli raporton me të dhëna zyrtare se numri i qenieve njerëzore të trafikuar është rritur në 5145 nga viti 2016 deri në vitin 2017. Sipas NCA-së, shumica e të trafikuarve janë nga Shqipëria. Ato trafikohen nga një rrjet i gjerë bandash, të cilat veprojnë në të gjithë Europën, ndërsa në gjuhën e tyre, ata e konsiderojnë si një shkëmbim "mallin", veprimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Për këtë fenomen të errët të shoqërive moderne ka folur edhe zvdrejtori i NCA-së, Tom Dowdall, i cili ka shpërndarë bandat shqiptare si të

rrezikshme, madje i cilëson ato si banda polikriminale. "Bandat kriminale të organizuara shqiptare janë duke operuar në mënyrë të sofistikuar edhe aktivitetin veç Britanisë së Bashkuar, ata ushtrojnë aktivitetin dhe në vende të tjera të BE". Ata janë ato që ne e quajmë "polikriminelët", shtoi ai. Media britanike sjell edhe histori të tjera, të cilat kanë si kryefjalë mashtrimin dhe detyrimin për të prostituar në rrugët e Anglisë, kjo e bërë nga bandat shqiptare, të cilat ende nuk janë kapur nga autoritetet angleze dhe ato europiane. Mediat sociale sipas "Sky News" janë përdorur nga këto banda për të shpallur njoftime për vende të lira pune e më pas gratë dhe vajzat kanë rënë pre e trafikimit seksual. Ndërkohë aktiviteti i këtyre bandave është shumë i zgjeruar, pasi krahas trafikut të qenieve njerëzore, ata kanë shitur edhe armë në disa vende të ndryshme.

Pala greke ndaloi kamionët e autobusët në kufi

ARRSH: Përdorni zinxhirë për të shmangur aksidentet

Reshjet e borës vësh tirësojnë kalimin e automjeteve në juglindje të vendit. Autoriteti Rrugor njofton të gjithë përdoruesit e automjeteve të përdorin zinxhirë për të evituar aksidente të panevojshme. Ndërkaq, në orët e para të mëngjesit të djeshëm Policia Kufitare nga pala greke ka njoftuar se në pikën e kalimit të Kapshticës për shkak të motit të keq nuk do të lejohet kalimi i kamionëve dhe autobusëve deri në normalizimin e situatës. Sipas tyre, mjetet e vogla do të lejohen të kalojnë në këtë aks drejt Greqisë vetëm duke përdorur zinxhirë. "Njoftohemi nga pala greke në Pikën e Kalimit Kufitar Kapshticë, se për shkak të motit të keq si dhe bllokimit të një aksi rrugor në territorin grek, nuk do të lejohet kalimi dhe qarkullimi i mjeteve të transportit autobusë dhe mjeteve të tonazhit të rëndë kamionë në drejtim të Greqisë, deri në normalizimin e situatës në këtë aks rrugor. Do lejohet kalimi i autovecurave, por vetëm me zinxhirë", thuhet në njoftim. Reshjet e



dëborës të nisura tri ditë më parë vijojnë në qarkun e Korçës. Trashësia e borës në Dardhë raportohet të ketë arritur deri në 40 centimetra. Reshje dëbore ka pasur edhe në Voskopojë e Kapshticë, ku trashësia ka arritur në 10 cm. Rruga e


Dardhës aktualisht është e kalueshme vetëm me zinxhirë. Ndërkohë, në akset e tjera nuk raportohen probleme në këtë qytet. Kujtojmë se fshati turistik i Dardhës njihet për vizitueshmërinë nga turistët në këtë stinë, pasi bardhësi e dëborës është një ftesë për të apasionuarit e stinës së dimrit.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbartimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të l-rë, për shitjen e pasurisë ULLISHTE, me sip.3,400 m², Zona Kadastrale: 1615

Numri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Sefer Skraqi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 2,720,000 (dy milion e shtatëqind e njëzet mijë) LEKË.

Ankandi do të zhvillohet më datë 21.11.2018, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbartimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.



TENDER NOTIFICATION

**FOR CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I
RECONSTRUCTION OF TAXIWAYS B, W AND W2
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for reconstruction of TAXIWAYS B, W AND W2.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist of: demolition of existing pavement taxiway structures, soil removal and excavations, drainage works, full construction of taxiways, reconstruction of taxiways, airfield lighting and all required installation and connection works.

To participate in this process interested parties will need to retrieve the Invitation to Tender and Confidentiality Commitment Document together with the respective forms, which can be retrieved at Tirana International Airport premises, Administration Building, Rinas, until 23 of November 2018.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I"

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania**

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 December 2018.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Takimet që kryen dy drejtorët e lartë të policisë

Asambleja e Përgjithshme të Interpolit, Veliu dhe Likaj përgëzohen për punën

Një delegacion i policisë shqiptare, i kryesuar nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe drejtori i Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar Drejtues, Andi Likaj, marrin pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit në Dubai. Në fillimin e Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit, delegacioni i policisë shqiptare zhvilloi një sërë takimesh, filli-

misht me delegacionin e Ministrisë së Brendshme të Emirateve të Bashkuara Arabe që përfaqësohej nga Ahmed Nasser Al-Raisi. Më pas një takim të veçantë me zvpresidentin e Interpolit, z. Kim Jong Yang dhe me shefin e delegacionit të USA me drejtorin Wayne H. Salzgaber, me zvpresidentin e përgjithshëm të policisë italiane si dhe me delegacionin e Argjentinës. Në të gjitha takimet, nga përfaqësuesit e delegacioneve është vlerë-

suar puna dhe rezultatet e arritura së fundmi nga Policia e Shtetit. Operacionet e fundit në Shqipëri, si dhe operacionet e përbashkëta me Interpol, Europol, Cepol, DEA, me policinë gjermane, spanjolle, italiane, franceze, britanike etj., tregojnë se Policia e Shtetit është partnerë e barabartë me policitë homologe. Veliu gjatë takimeve ka theksuar se bashkëpunimi me partnerët është një nga prioritetet kryesore të Policisë së Shtetit. Tashmë,

Policia e Shtetit ka arritur besueshmëri dhe bashkëpunim mjaft të konsoliduar me partnerët, kjo certifikuar edhe nga organizmat ndërkombëtare policore, ku Policia e Shtetit u vlerësua me dy çmime të para për dy operacione të rëndësishme ndërkombëtare. Asambleja e Përgjithshme të Interpolit është event i madh botëror në lidhje me bashkëpunimin policor ndërkombëtar. Në këtë asamble, e cila është e 87-ta dhe mbahet



në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe, marrin pjesë 173 shtete, të cilat përfaqësohen nga 85 drejtorë të përgjithshëm të policisë dhe 40 ministra.

Nga vrasjet te mashtrimi, kush janë të shumëkërkuarit e drejtësisë

Policia e Shtetit: 22 më të kërkuarit në qarkun e Dibrës

Mes tyre, edhe një femër e dënuar me 25 vite burg

Policia e Shtetit zbulon listën me 22 më të kërkuarit e drejtësisë në qarkun e Dibrës. Blutë u kërkohen qytetarëve që nëse kanë informacion për vendndodhjen e këtyre personave, të lajmërojnë në numrin pa pagesë 112, duke u premtuar anonimat. "Ndihmo edhe ti në sigurinë publike" thuhet në njoftimin e policisë, e cila me sa duket po përdor strategjinë e parqitjes në publik të të shumëkërkuarve, me qëllim bashkëpunimin me qytetarët. Në mes të 22 të kërkuarve është edhe një femër e quajtur Lumije Hoxha, e cila ishte e dënuar me 25 vite burg dhe është

të larguar nga burgu në të cilin ndodhej. Publikimi i bë nëpërmjet rrjetit social "Facebook", ku shfaqet mosha, foto dhe vepra penale e të kërkuarve nga drejtësia. Pjesa më e madhe e të kërkuarve nga

drejtësia janë dënuar për veprën penale "Vrasje" dhe dënimet variojnë nga 25 deri në 6 vite burg. Në mes të listës bien në sy të dënuarit për vjedhje me dhunë, shfrytëzim prostitucioni, por edhe për mashtrim.

LISTA E PERSONAVE TË SHPALLUR NE KERKIM

- Hysni Ferit Hastoçi, i dënuar për vrasje me 25 vjet burg.
- Kadri Sali Hoxha, i dënuar për vrasje me 25 vjet burg.
- Ilirjan Pjetër Gjeçi, i larguar nga burgu, i dënuar me 25 vjet burg.
- Lumije Halit Hoxha, e larguar nga burgu, e dënuar me 25 vjet burg.
- Besnik Met Coka, i dënuar për vrasje me 25 vjet burg.
- Sabri Ismet Sopoti, i dënuar për vrasje me 24 vjet burg.
- Lavdrim Hysen Gjinaj, i dënuar për vrasje me 22 vjet burg.
- Behar Ali Barçi, i dënuar për vrasje me 18 vjet burg.
- Mentor Shefki Hasani, i dënuar për vrasje me 17 vjet burg.
- Zabit Zabit Fisniku, i dënuar për trafik femrash me 16 vjet burg.
- Emir Kol Skeja, i dënuar për vrasje me 16 vjet burg.
- Prend Gjon Kola, i dënuar për mashtrim me 12 vjet burg.
- Bashkim Ali Shehi, i dënuar për favorizim prostitucioni me 10 vjet burg.
- Shaban Musli Kokaj, i larguar nga burgu, dënua 9 vjet.
- Albert Shefqet Daci, i dënuar për shfrytëzim prostitucioni me 8 vjet burg.
- Astrit Remzi Dedja, i dënuar për vjedhje me armë me 7 vjet burg.
- Leo Zyber Roçi, i dënuar për vjedhje me dhunë me 7 vjet burg.
- Erion Hysen Uka i dënua për vrasje me 7 vjet burg
- Vehap Ahmet Shehu, i dënua për vrasje me 6 vjet burg.
- Isak Naim Buna, i dënua me 5 vjet burg për kanosje me armë.
- Denis Beqir Havalja, i dënua 5 vjet për marrëdhënie seksuale.
- Alban Zef Gjegji, i dënua 7 vjet burg për pjesëmarrje në grup kriminal.

<p>I KËRKUAR PREND GJON KOLA Dënim: 12 vjet</p> <p>18.06.1956 Lezha Veprimet: Lehtë Vepra penale: "Mashtrim"</p>	<p>I KËRKUAR ALBAN ZEF GJEGJI Dënim: 7 vjet</p> <p>04.06.1975 Madhesht, Mat Veprimet: Madhesht, Mat Vepra penale: "Drap kriminale"</p>	<p>I KËRKUAR DENIS (DASHAMIR) BEQIR HAVALJA Dënim: 5 vjet</p> <p>23.12.1986 Cërreçaj, Mat Veprimet: Cërreçaj, Mat Vepra penale: "Marrëdhënie seksuale"</p>
<p>I KËRKUAR ERIMIR KOL SKEJA Dënim: 16 vjet</p> <p>21.07.1984 Bushkash, Mat Veprimet: Bushkash, Mat Vepra penale: "Vrasje"</p>	<p>I KËRKUAR ISAK NAIM BUNA Dënim: 5 vjet</p> <p>24.04.1995 Zenisht, Mat Veprimet: Zenisht, Mat Vepra penale: "Kanosje me armë"</p>	<p>I KËRKUAR VEHAP AHMET SHEHU Dënim: 6 vjet</p> <p>28.08.1975 Dushaj, Bulqizë Veprimet: Dushaj, Bulqizë Vepra penale: "Vrasje"</p>

Njoftim shitje me ankand

Shoqëria përmbarimore "AA Bailiff" sh.p.k, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme. Trulli 128m2 dhe ndërtesë 81 m2, me Nr. pasurie 2/339, ZK 8511, vll. 15, flk. 127, ne pronësi te Qemal Mahmut Skora e regjistruar në ZVRPP Durrës.

Cmimi i ankandit të trete është EUR 40,118 (dyzetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë euro).

Ankandi zhvillohet dt. 03.12.2018, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë.

Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabailiff@gmail.com.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE "ILIA ELEZI"

Pasuria e paluajtshme kolaterale të llojit "Pyll + Kullotë", me sipërfaqe totale 190.000 m2, zona kadastrale 3028, me adresë POROVLORE, në pronësi të hipotekuesit z. FATION UKA.

ÇMIMI 1.149.120 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 27.11.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

SHPALLJE ANKANDI
Datë 23.11.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të dorëzuarës **Batjar Alush Murro**:

-"Trulli + Ndërtesë" me sipërfaqe trulli 300 m² dhe ndërtesë 81 m², regjistruar në regjistrin hipotekor me volum nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. pasurisë 987, adresa: Shalës, Sarandë.

Cmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 907 200 (nëntëqind e shtatë mijë e dyqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

NGACMIMET SEKSUALE

INTERVISTA

Sociologia: Viktimat kanë frikë të denoncojnë. Rritje e shifrave në 2 dekadat e fundit

"Ngacmimet seksuale, punëdhënësit e martuar kërcënojnë vajzat e reja"

Entela Binjaku: Shfrytëzim posti, në këmbim të favoreve seksuale

Voltiza Duro

Me ardhjen e demokracisë, ngacmimi seksual në vendin e punës është kthyer në një dukuri shqetësuese për shumë gra e vajza. Por frika nga mentaliteti e opinionin i shoqërisë i ndrydh femrat që bien pre e këtij fenomeni e si pasojë ato vetëm vuajnë në heshtje. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", sociologia Entela Binjaku tregon se ngacmimet seksuale në vendin e punës kanë formë nga më të ndryshmet, duke nisur nga prekjet apo lehatimet, komente apo fjalë të padëshiruara lidhur me jetën private. Sipas saj, punëdhënësit në raste të refuzimit të këtyre ngacmimeve, kanë arritur deri tek kërcënimin për vendin e punës, refuzimin e rritjes në detyrë apo rritjes së rrogës. Binjaku shton se ky fenomen përherë ka gjetur viktimat dhe kalvari i tyre nuk ka rështur me kohën. Edhe pse në mënyrë informale pohohet se në këtë 10-vjeçar të dytë është më e përhapur, për aq kohë sa nuk është denoncuar as në dekadën e kaluar, ajo ka mbetur nën hije dhe është një anë e errët e shoqërisë sonë. Sipas Binjakut, në përgjithësi ngacmimi seksual ka ardhur nga vartësit e gjinisë femërore dhe në rastin e drejtuesit, shumica shprehen se ato janë kryer nga individë të gjinisë mashkullore, ndërsa në lidhje me statusin martesor, në shumicën e rasteve ata të cilët kryejnë ngacmime seksuale janë të martuar.



Sociologia Entela Binjaku

Nga eksperiencia juaj si sociologe, si paraqitet kurba e fenomenit të ngacmimeve seksuale në vendin e punës?

Rasti i mediatizuar i Harvey Weinsteinin një producent i famshëm, bashkëthemelues i shtëpisë "Miramax" tregoi një valë të madhe akuzash mbi të nga ana e shumë personazheve publike. Një lëvizje shumë befusuese e solidarizuar e femrave të Hollivudit, që të ushqyera nga njëra-tjetra nisën të flasin për abuzim seksual fizik apo psikik të shkaktuar nga ky producent, vite më parë. Ndoshta ky rast na bëri të mendojmë edhe ne se si qëndrojmë në këtë drejtim. Dukuria e ngacmimit seksual në vendin e punës nuk është e re në këto 25 vitet e fundit. Ajo merr formë nga më të ndryshmet duke nisur

që nga prekjet apo lehatimet që njihet si ngacmim fizik, komente apo fjalë të padëshiruara lidhur me jetën private dhe kjo njihet si ngacmim verbal, deri tek kërcënimin me vendin e punës, me refuzimin që i bëhet rritjes në detyrë apo rritjes së rrogës në raste të refuzimit të këtyre ngacmimeve. Ngacmimi mund të jetë i drejtpërdrejtë përmes dhunës verbale apo fizike apo jo i drejtpërdrejtë përmes sjelljeve izoluese, që diskriminojnë apo përrjashojnë dikë. Për të kuptuar shkallën e ngacmimeve dhe kurbën e zhvillimit të tyre duhet të kuptojmë sa prej këtyre formave, vajzat apo gratë shqiptare kanë përjetuar në vendin e punës. Ajo që mund të themi me siguri është se kjo dukuri nuk ka njohur ulje me kalimin e

kohës, por vijon të mbesë aktuale në çdo situatë. Në mënyrë informale shumë vajza dhe gra e pohojnë këtë gjë.

A ka statistika zyrtare lidhur me fenomenin në fjalë?

Statistika zyrtare mungojnë lidhur me këtë dukuri. Por edhe sikur të ishin, sërish në realitet dukuria ndodh shumë më shumë sesa raportohet. Edhe pse ekzistojnë zgjidhje ligjore për t'u mbrojtur prej ngacmimit seksual, shumë pak raste arrijnë deri në gjykatë. Gratë dhe vajzat sot mund të denoncojnë dhunën dhe ngacmimet seksuale në polici, prokurori, tek Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit. Të punësuarat që bëjnë ankesë për këtë janë shumë të pakta, sepse ose ndjehen fajtose ose frikë-



NGACMIME NGA TË MARTUARIT

"Sa i takon pozicionin të punës, në përgjithësi ngacmimi seksual ka ardhur nga vartësit e gjinisë femërore dhe në rastin e drejtuesit, shumica shprehen se ato janë kryer nga individë të gjinisë mashkullore. Në lidhje me statusin martesor, në shumicën e rasteve ata të cilët kryejnë ngacmime seksuale janë të martuar", - thotë Binjaku.

DENONCIMET

"Te ne shumë gra dhe vajza zgjedhin të keqen më të vogël, sepse ndihen të pafuqishme, nuk e konsiderojnë veten të mbrojtur nga ligji, sanksionohen nga njerëzit që i rrethojnë, kritikohen, jetojnë tensione gjithmonë e më të mëdha, të frikësuar se po humbasin vendin e punës, druhen se nuk janë të besueshme për atë që përjetojnë", - shprehet sociologia.

ngacmimet seksuale në vendin e punës?

Në realitetin e përditshëm tonin është e vështirë të presësh denoncime të tilla, sepse shpesh ato shoqërohen me pasiguri të mëdha lidhur me pasojat. Shumë gra bashkëjetojnë me heshtjen në mënyrë të përdhushme vetëm e vetëm që të mos humbasin edhe atë status-quo që kanë arritur. Raportime dhe denoncime ka më shumë nga emisione investigative në vendin tonë, të cilat kanë bërë të mundur shfaqjen në publik, nëpërmjet kamerave të fshehtëta të rasteve abuzive nga drejtuesit të administratës, të cilat janë bërë të njohura nga publiku i gjerë.

Cilat janë grupmoshat më të prekura?

Ngacmimi seksual është i përhapur në Sh-

Shoqëria permbarrimore JUSTITIA

Shoqëria permbarrimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, për të cilat ka venë hipoteke NGB Bank, me këto të dhëna:

- Lloji i njësimit sip. 189 m² nr.pasurie 5/188nd-01, zk.8350 vol 28 fq146 RR.P.Myzocqari TIRANË në pronësi të Z.Ajlan Rahmi BAHOLLU
- Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 256.800 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) EUR
- Lloji i apartamentit sip.122m² zk.8350 nr.pas.5/188nd-1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Myzoqari TIRANË në pronësi të Z.Ajlan Rahmi BAHOLLU
- Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 105.600 (njëqind e pesë mijë e gjashtëqind) EUR
- Ankandi zhvillohet në datën 03.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbarrimit gjyqësor, me adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria permbarrimore JUSTITIA

Shoqëria permbarrimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka venë hipoteke NGB BANK, me këto të dhëna:

- Lloji i pasurisë ARe+ Truall me sip. 3000 m², nr.pasurie 58/9 vol 8 fq78, zk.1475 V. Dervën, KRUIJË
- Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) EUR, Ankandi zhvillohet në datën 04.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbarrimit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shitje me Ankand të trete nga Studio Permbarrimore L.D.C

-1. "Ndertesë", me sipërfaqe 600 m², me Nr. Pasurie 495/15, Vulum 5, faga 83, ndodhur në Zonen kadastrale 3426 me adresë në Tufinë, Tiranë. Regjistruar në Zyrën Vendore Regjistrimit Pasurie Paluajtshme Tiranë.Çmimi fillestar për shitje është 2.116.800 leke.

Data e shpalljes 30.10.2018
Data e zhvillimit 03.11.2018 deri në orën 16.00

Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.



← qipëri, sidomos te punëmarrëset femra në moshë të re, ato beqare apo të divorcuara. Të rejtat që janë në fillimet e veta në tregun e punës, që janë të reja në pozicione të caktuara, që vijnë nga zona të varfra të vendit, apo nga familje të varfra, që kanë pak mbështetje apo lidhje të dobëta familjare. Ngacmimi në këto raste vjen nga punëdhënës, që kanë një pozicion drejtues, duke shfrytëzuar pozitën e tyre në këmbim të favoreve seksuale. Në shumicën e rasteve ngacmimi seksual ka ardhur nga kolegë të punës të gjinisë mashkullore. Sa i takon pozicionin të punës, në përgjithësi ngacmimi seksual ka ardhur nga vartësit e gjinisë femërore dhe në rastin e drejtuesit, shumica shprehën se ato janë kryer nga individë të gjinisë mashkullore. Në lidhje me statusin martesor, në shumicën e rasteve ata të cilët kryejnë ngacmime seksuale janë të martuar.

Në cilën prej dekadave të fundit ka pasur më shumë ngacmime në vendin e punës?

Kjo dukuri e lidhur me varfërinë, me vështirësitë për gjetjen e vendit të punës, me mungesën e ndëshkimeve ndaj agresorëve, me heshtjen e viktimave ka mbetur konstante sa i takon pranisë së saj. Në çdo vit kjo dukuri nuk ka njohur ulje apo ngritje. Ajo përherë ka gjetur viktimë dhe kalvari i viktimave nuk ka reshur me kohën. Edhe pse në mënyrë informale pohohet se në këtë 10-vjeçar të dytë është më e përhapur, për aq kohë sa nuk është denoncuar as në dekadën e kaluar, ajo ka mbetur nën hije dhe është një anë e errët e shoqërisë sonë.

A denoncohen rastet apo mentaliteti dhe frika e humbjes së vendit të punës i ndrydh viktimat për të shprehur shqetësimin e

tyre?

Tek ne shumë gra dhe vajza zgjedhin të keqen më të vogël, sepse ndihen të pafuqishme, nuk e konsiderojnë veten të mbrojtur nga ligji, sanksionohen nga njerëzit që i rrethojnë, kritikohen, jetojnë tensione gjithmonë e më të mëdha, të frikësuar se po humbasin vendin e punës, druhen se nuk janë të besueshme për atë që përjetojnë. Në shumë raste ka femra që pohojnë se kjo ndodh vetëm në imagjinatën e tyre, apo se janë ato që i ftojnë vetë ngacmimet me sjelljen e tyre, apo se janë vetëm ato që i interpretojnë këto sjellje në këtë formë etj. Femra që kalon në një situatë të tillë nga njëra anë ndjehet e pafuqishme, nga ana tjetër ndjehet e shqetësuar, e frikësuar apo e zemëruar prej sjelljeve të një kolegu apo shefi. Shkon me frikë në atë punë ku shkonte me dëshirë, nuk di si të shmangë atë që e shqetëson. Ndjehet në kurtër. Kur refuzon, ajo është viktimë që jeton me frikën e pasojave: që do ta heqin nga puna, që do ta vendosin në situatë të vështira, që do të duhet të heqë dorë nga një punë që kishte rëndësi për të etj. Nuk arrin të përquadrëhet në atë që ka detyrë të bëjë, nuk jep rendiment, nuk përparon dhe as nuk merr vlerësim për cilësinë e punës që kryen, i vjen zor të shkëmbejë vështrim me atë që e ngacmon, nuk di si të silllet me të, ka frikë se me sjelljen e saj rëndon situatën, i vjen zor nga çfarë do të mendojnë kolegët, pra të gjitha këto qëndrojnë në mendjen e një viktime të ngacmimit seksual. Rastet më të bujshme në Perëndim kanë pasur sukses kur janë bërë shumë gra që kanë folur për atë që u ka ndodhur në vendin e punës. Kur bashkohen, ato nuk mund të injorohen më dhe masat mënyrë apo një tjetër, duhen marrë apo edhe merren.

Entela Binjaku: Fenomeni, i përhapur edhe brenda së njëjtës gjini, por mbetet i fshehur

Sociologjia: Femrat e angazhuara në politikë, pre e ngacmimeve seksuale

"Raste ku vajzat e gratë bëjnë kompromis për rritje në detyrë"

Voltiza Duro

Në ditët e sotme femrat e suksesshme dhe në karrierë, shpeshherë mund të bien pre e ngacmimeve seksuale në vendin e punës. Sociologjia Entela Binjaku në intervistën e saj për "Gazeta Shqiptare" pohon se jo rrallëherë gratë kanë zgjedhur që ta ndërtojnë karrierën e tyre mbi bazën e kompromiseve që kanë bërë dhe kjo nuk i ka përjashtuar edhe kompromiset e favoreve seksuale. Sipas Binjakut, ky është shpjegimi që mund t'u jepet ngritjeve apo promovimeve të disa femrave që janë larg parametrave të formimit, përvojës, meritës që kërkon një pozicion i caktuar që për përbushjen e rolit që i takon kërkon parametra, të cilat disa as nuk arrijnë t'u afrohen me përgatitjen apo ngritjen që kanë. Sociologjia më tej thekson se edhe vajzat e gratë e angazhuara në sferën politike janë ngurruese e kanë frikë të denoncojnë goftë rastet e ngacmimeve morale, ashtu edhe të atyre seksuale. Ajo shton se gjithë ky frustrim seksual i burrave shqiptarë vjen më së tepërmi nga tipologjia që ata kanë krijuar për femrën, ku shpeshherë ata kanë pasur të bëjnë me femra të varura ekonomikisht, gjithmonë të heshtura dhe të dëgjueshme dhe ku pozita sociale e tyre përcaktohet falë meshkujve.

Në rang kombëtar, në cilat qytete është më i përhapur fenomeni i ngacmimeve seksuale në punë?

Në mungesë të statistikave është e vështirë të pohohet kjo gjë, por ndoshta kryeqyteti për shkak se përbën tregun më të madh të punës, ku kërkesat janë më të larta dhe mundësitë janë më të pakta. Në qytetet e tjera mendësia tradicionale, lidhjet familjare dhe njohjet e bëjnë më të vështirë këtë dukuri, ose së paku e frenojnë disi.

A janë evidentuar rastet të këtij fenomeni brenda të njëjtit seks?




Foto Ilustruese

Raste të tilla ka dhe nuk mungojnë. Edhe pse vështirë për t'u ndarë me të tjerë, ngacmimet brenda gjinisë nuk janë një dukuri e panjohur. Shpesh pohohet se ata që ndajnë preferencën të njëjta janë më të favorizuar në vendin e punës, apo nëse refuzojnë, ndjehen të përjashtuar nga shumë mundësi që i lejon legjislacionin në vendin e punës. Në shumë raste këto problematika mbeten aq të fshehura dhe në heshtje mes palëve të përfshira (viktimitë-viktimizuesit), saqë as në familje nuk bëhen të ditura. Kjo e vështirëson analizën.

A ka pasur raste të denoncuar për persona publike dhe politikane?

Raste të tilla kemi parë psh., kur një material audio i përgjuar vendosi në qendër të opinionit një politikane të lartë në Maqedoni. Edhe pse ajo bëri shumë përpjekje për të përballuar këtë situatë, fakt është që ajo si figurë publike tashmë ka dalë nga skena politike. Gjë e cila tregon se mbi gruan pasojat janë të forta dhe të pamëshirshme. Megjithatë, ato janë ngurruese dhe kanë frikë të denoncojnë goftë rastet e ngacmimeve morale, ashtu edhe të atyre seksuale. Lëvizjet të mëdha dhe të ndërkombëtarizuara si "#Me too"

pikërisht këtë synojnë: që femrat të mos frikën të denoncojnë, ato nisin pikërisht nga femra me ndikim në botë, sepse fjala e tyre peshon në opinion, aq sa arrijnë të rrezojnë edhe mite të ndërtuara. Por ato janë shoqëri shumë të zhvilluara pikërisht sepse gruan e kanë ngritur në atë nivel që ato janë të lira të denoncojnë pa pasur frikën se parajgjykoen se braktisen, apo se depersonalizohen.

Sa të ekspozuara janë femrat e angazhuara në politikë ndaj ngacmimeve seksuale?

Në mjediset tona të mbushura me protagonizëm mashkullor, është e vështirë që gratë të depërtojnë, të përfaqësojnë mbështetësit e tyre etj. Dukuri të tilla janë të vështira të mësohen, sepse edhe ato vetë nuk do ta kishin shprehur nëse janë ndër të tilla. Të gjithë ne jemi produkt i së njëjtës mendësi kulturore dhe i të njëjtës psikologji shoqërore. Por shpesh ka gra që karrierën e kanë ndërtonuar mbi bazën e kompromiseve që kanë bërë dhe kjo nuk i ka përjashtuar edhe kompromiset e kësaj natyre. Ndryshe nuk ke si i shpjegon ngritjet apo promovimet e disave që janë larg parametrave të formimit, përvojës, meritës që kërkon një pozicion i

KOMPROMISET

"Shpesh ka gra që karrierën e kanë ndërtonuar mbi bazën e kompromiseve që kanë bërë dhe kjo nuk i ka përjashtuar edhe kompromiset e kësaj natyre. Ndryshe nuk ke si i shpjegon ngritjet apo promovimet e disave që janë larg parametrave të formimit, përvojës, meritës që kërkon një pozicion i caktuar, që për përbushjen e rolit që i takon kërkon parametra, të cilat disa as nuk arrijnë t'u afrohen me përgatitjen apo ngritjen që kanë".

caktuar që për përbushjen e rolit që i takon kërkon parametra, të cilat disa as nuk arrijnë t'u afrohen me përgatitjen apo ngritjen që kanë.

Pse vjen ky frustrim nga meshkujt shqiptarë?

Sot "ngacmimi seksual" shikohet si një çështje e të drejtave të njeriut. Aristoteli thoshte "gjëja më e mirë në jetë është dija, ndërsa gjëja më e keqe është injoranca". Dija lidhet me rolin e gruas në shoqëri, të drejtat e saj, statusin e individit në vendin e punës, edukimi me kodin etik, njohjen e koncepteve të së drejtës. Sot tek ne dëgjon shpesh shprehjen "pas një burri të suksesshëm qëndron një femër e fortë". Kjo shprehje nuk di pse përdoret si kompliment, sepse kjo tregon rolin në hije të gruas, goftë edhe kur ajo është e talentuar dhe inteligjente, madje shumë më tepër se burri që ajo e drejton drejt një karriere të përbushur. Sot edhe tipologjia e "femrës së pavarur dhe me karrierë" tek ne përdoret si me sarkazëm ose ironi. Kjo tipologji bie ndesh me idenë e burrave që janë mësuar të sillen me femra të varura ekonomikisht, gjithmonë të heshtura dhe të dëgjueshme, të varura ekonomikisht dhe ku pozita sociale e tyre përcaktohet falë meshkujve.

DEBATI

IRAKLI KOÇOLLARI:

Profili kompleks i Mit'hat Frashërit, çfarë thonë dokumentet gjermane e amerikane

PROF. Irakli Koçollari

Eshtë shumë e vjetruar, madje një banalitet urban i rëndomtë dhe i tejkaluar sloganin që përdoret shpesh, se "Historinë e bëjnë fitimtarët!"

Jo!
Askund dhe askurrë historinë e vërtetë nuk e kanë bërë ata. Fitimtarët mund të shkruajnë histori, por kjo nuk do të thotë se ata e bënë vërtetë historinë! As Cezari as Hanibali, as Kaligula, as Neroni; as perandorët bizantinë, Teodosët, Justinianët, Laskarët, Paleologët, por sigurisht as Hitlerët, Musolinët apo ndonjë politikan tjetër fitimtar a humbës i kohëve moderne nuk ka mundur të "bëjë historinë".

Historia bëhet në çastin kur ndodh! Historia bëhet atë mot dhe ato orë kur heronjtë dhe popujt kanë vendur ide të dhe hapat e tyre në vorbullat e mëdha të kohëve.

Historianët vetëm e shkruajnë atë. Ata kanë për mision dhe detyrë të brendshme të identifikojnë ngjarjet dhe personazhet, të mbledhin dëshmitë dokumentare, pohimet e të pranishmëve okularë, moralin dhe idetë filozofike të kohës, rrethanat që shoqëruan dhe ndikuan rrjedhat e ngjarjeve. Dhe në këtë proces, "detyra e parë e historianëve është të shmangin gënjeshttrat, e dytë të mos fshehin të vërtetën, e treta të mos japin asnjë shkas që të dyshojnë për anësi", thoshte Ciceroni.

HISTORINË NUK E BËJNË DOT AS "FITIMTARËT" E RINJ

Mos më keq, nëse shkrimin e historisë tentojnë ta bëjnë politikanët e rinj, apo fitimtarët e rinj, të cilët me ankthet e padurimit të fshehur dalin papritur, përparmësi dhe lebetiten se "politika nuk duhet të ndërhynte dhe të bënte historinë..."

Por, kur politikanët e rinj, nuk bëjnë asgjë më shumë dhe as më pak nga sa kishin bërë pararendësit, përmes thirrjeve nga tribunat e pushteteve, cili është ndryshimi mes "fitimtarëve të shkuar që bënë historinë dhe fitimtarëve të rinj që duan ta bëjnë atë"? "Bëni si them unë, por mos bëni si bëj unë", ishte mesazhi i madh i predikimit, të asaj që ndodhi në mes të ditës me diell..."

Implikimi i politikantit në histori bëhet për dy motive; ose për përfitime të caktuara politike ose për interesa egoiste intelektualiste (jo intelektualale).

Sigurisht, politikanët fitimtarë apo tiranët mund të bërtasin, të kërcënojnë apo të kërkojnë që të gjithë turmat të përulën përpara mendimit të tyre, përpara shpirtit që ata kanë, narcizimit të tyre, por kjo kursseje nuk do të thotë se ata në këtë mënyrë kanë fituar dhe fundit dhe e bënë vërtetë historinë për njerëzit dhe kohët e tyre.

Individe që kanë armën e pushtetit mund ta kërcënojnë të vërtetën por

Historiani: Historinë nuk e ka bërë dot asnjë fitimtar!



Mit'hat Frashëri

kurrë mos mendojë se do ta trembë atë, madje mund ta djegë të vërtetën në turrën e druve, por kurrë nuk mund ta kthejë atë në hi, mund ta vrasë atë edhe pas shpine por kurrë nuk shuan dot shpirtin e shenjtë të saj. Udrow Willson thoshte: "... në këtë vend askush, aq më pak qeveritarët, nuk kanë të drejtë të imponohen, të përfitojnë nga funksioni që mbajnë, aq më pak të përfitojnë nga ligji".

(Dritëroi thotë: Në sofrën e historisë kërkohet të ulen shumë, por historia i përçjell...)

Eventi dhe debati rreth figurës së Mit'hatit

Ditët e fundit, një pjesë e mirë e opinionit vendës pa të sullen në median e shkruar dhe atë vizive, për të thënë të vërtetë dhe të pavërtetë historike, të thurin ditirambe, të përpigën të emocionojnë, të ngazëllojnë dhe të rrënojnë audiencat, historianët e publicistët, mekanikë dhe aktorë, barinj dhe pensionistë, të harruar dhe politikanë, nostalgjikë dhe mllëfahinj... për një subjekt - Mit'hat Frashërin!

Ishte fjala për të thënë dhe mosthënë disa çështje të biografisë të këtij njeriu, për të pohuar disa të vërteta apo për t'i mohuar ato, për të nxjerrë në dritë apo për të fshehur tinëz disa cene; për të prezantuar faqen e ndritur apo për të shmangur ndonjë cilfosje të suvasë shkaktuar dikur; për të pranuar atë si "figuri ideale dhe madhështore" si askush në historinë tonë - apo për ta pranuar atë si një figurë komplekse me pjesë të ndritura dhe anë të errëta!

Një pjesë e oratorëve në panelet e shumta të debatit, tentoi të ndriçojë vetëm anët e ndritura të subjektit dhe

të heshtë apo "të harrojë" anë që zbulonin pjesën e kompromentuar të tij, ato që cenonin "imazhin ideal" të protagonistit. Pjesa tjetër qëndronte në fronin e moderuar, duke evidentuar prurjet dhe kontributet, por duke zbuluar edhe rrethqijet fatale të Mit'hat Frashërit...

Sigurisht, për kontributet e kësaj figure në fushat dhe lëmi të arsimit, kulturës, historisë, diplomacisë dhe çështjes kombëtare u shkrua shumë mbas viteve '90. Ka ende shumë për të folur veçmas për kontributet e tij në fushën e Albanologjisë apo të përplekjeve të tij në mbrojtjen e popullsisë çame nga gjenocidi grek. Folësit e emocionuar gjer në përdorimin e "fjalëzave" dhe "materialit lëndor" të Frashërit fatkeqësisht nuk folën fare për këto prurje me vlerë të këtij njeriu...! Përse nuk e bënë këtë këta patriot, nuk e dimë!

Por, duam apo nuk duam sot disa indikatorë, për të cilët dyshojmë se e njohim fare pak apo aspak figurën dhe kontributet komplekse të Mit'hat Frashërit edhe në këto fusha, aq më pak të kenë shfletuar ndonjë material dokumentar apo arkivor rreth tij... Do të ndalim të themi pak nga provat e shumta, që plotësojnë profilin kompleks të frashërlit.

Kjo figurë nuk mund të lihej larg dhe mënjanojë veprimtarisë së tij, roli si drejtues kryesor i Organizatës Politike që ai udhëhoqi, "Ballin Kombëtar", në vitet e Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj!

"Le të guxojmë të lexojmë, të mendojmë, të flasim dhe të shkruajmë të lirë!" therriste njëri prej hartuesve të Deklaratës së pavarësisë së SHBA, Xhon Adams.

Balli Kombëtar dhe lidhshipi i tij gjatë Luftës së Dytë Botërore

Balli Kombëtar ishte organizata e dytë politike shqiptare e formuar në vitet e pushtimit fashist të Shqipërisë, në nëntor 1942, gati një vit pas krijimit të PKSH. Megjithatë ka kaluar më shumë se gjysmë shekulli nga kohë kur kjo organizatë ushtroi veprimtarinë e saj, ende sot e kësaj dite ka debate rreth një çështje krushiale, mjaft domethënëse, që përcakton profilin identitar të saj, boshtin gravitacional që pozicionon çdo forcë politike përpara misionit dhe altarit të shenjtë ndaj atdheut.

Në momentin e vështirë, të rëndë dhe ekzistencial të pushtimit të vendit - cili ishte qëndrimi i saj i vërtetë ndaj okupatorit, italian dhe atij gjerman? - A mori udhëheqja e kësaj organizate politike një qëndrim të qartë dhe të prerë, një obligim, sakrificë vitale për interesat dhe fatet e vendit, - luftë pa kompromis kundër pushtuesit të Atdheut?! Në fund të fundit - A ishte themelimi i kësaj organizate një ndërmarje që synonte të realizonte detyrën akute, parësore dhe të shenjtë njëkohësisht që shtronte përpara të popujve të Europës, por edhe popullit shqiptar, ato ditë të rënda të pushtimit?

Analisti dhe historiani konteporan më në zë amerikan, Bernd Fisher, i cili ka punuar me mjaft vëmendje për këtë periudhë historike dhe rolin e partive apo formacioneve politike shqiptare, në Luftën e Dytë Botërore, bën me dije se "... liberalët nacionalistë, disa prej të cilëve kishin vendosur gjithsesi disa lidhje të dobëta me LNC, në Nëntor të vitit 1942 formuan një grup të quajtur 'Balli Kombëtar'. Ky grup shpresonte të përbente një organizatë politike dhe ushtarake për të moderuarit që nuk kishin besim tek komunistët. Udhëheqësit e BK pretendonin se grupi ishte krijuar qysh prej ditës së parë të pushtimit italian dhe në të vërtetë me disa ish politikanë ka ekzistuar një farë organizimi jo zyrtar, por organizimi dhe platforma e BK ishin qartazi një reagim i drejtpërdrejtë ndaj themelimit të LNC. (shih Bernd Fisher, 184-185).

Pra, qysh në fillim Fisher qartëson se shënjestra e kësaj strukture ishte "reagim i drejtpërdrejtë ndaj themelimit të Frontit Nacional Çlirimtar..." dhe jo lufta pa kompromis kundër pushtuesve të vendit.

Duke analizuar edhe më tej platformën dhe qëllimet e krijimit të kësaj organizate, po ky analist, Fisheri duke iu referuar tërë dokumentacionit arkivor të kohës nënvizon, "BK u formua jo për të luftuar pushtuesin por më tepër për të shkatërruar punën politike të PK. Komiteti Qendror i BK, i krijuar për të drejtuar vijën politike përfshinte edhe disa anëtarë të moderuar të rinj, por meqenëse këta u arrestuan shpejt nga italianët, drejtimi i Ballit i mbeti anëtarëve në të vjetër në moshe, të prirur ndaj kolaboracionizmit me pushtuesin." (shih Bernd Fisher, 184-



185).

Por, duke shkruar pak më përpara në kohë, në ditët e krijimit të kësaj organizate, rrethanave në të cilat ajo do të formohej, Francesco Jakomoni, guvernatori real i Shqipërisë nën pushtimin Italian dhe Mëkëmbës i Viktor Emanuelit në Shqipëri, në librin e tij të kujtimeve, "La politica dell'Italia in Albania", na sjell fakte mjaft të rënda, kompromentuese dhe tepër domethënëse rreth këtij akti historik. Guvernatori fashist shkruan se "për formimin e Ballit Kombëtar ka kontribuar me shumën prej katërmëdhjetë mijë lekësh, një shumë kjo jashtëzakonisht e madhe për kohën". (Jakomoni, Francesco: "La politica dell'Italia in Albania", Roma, 1965).

Të njëjtin mendim dhe përfundim ka për këtë organizatë edhe ushtaraku amerikan, Peter Lukas, i cili shërbeu në misionet amerikane gjatë Luftës së Dytë Botërore në territoret shqiptare. Në librin e tij të kujtimeve, ai pohon: "Balli Kombëtar ishte një organizatë antikomuniste nacionaliste, që kërkonte të merrte drejtimin e vendit. Kjo organizatë bashkëpunoi me pushtuesit gjermanë..." (Piter Lukas f. 17).

Dhe vërtet, ngjarjet e mëvona rrefyeshme qartë se nga radhët e kësaj organizate dolën elementë si Ali Këlcyra dhe Rexhep Mitrovica, të cilët më vonë do të kryesojnë një qeveri kolaboracioniste nën pushtimin gjerman, konkludon Bern Fisher (Bern Fisher 185).

Fakte të tjera me interes rreth kësaj organizate sjell Xhelal Staravecka, këmbaloracionist i pushtuesve gjermanë, Komandanti i Xhandarmërisë, në kohën e pushtimit gjerman të vendit, në librin e tij të kujtimeve, "Përpara gjyqit të Historisë". Ai na sjell në vëmendje se "Kur u formuan çetat e Ballit, ato na dolën të armatosur me pushtë të gjata italiane... Dhe kur duhej të transferoheshin nga një qytet në tjetrin, transferimin e bënin me mjetet e okupatorit, me kamionë ushtarakë italianë. Kjo ka qenë arsyeja se përse organizata e "Ballit Kombëtar" nuk çliroi asnjë katund, sepse ajo ishte rojtare e okupatorit." (Xhelal Staravecka "Përpara gjyqit të historisë", Naimi, Tiranë 2009, f. 220).

Duke iu referuar edhe më tej dokumenteve arkivore të njërit prej misionarëve britanikë në Shqipërinë e okupuar gjatë viteve të Luftës së Dytë, pra një dëshmitar okular të atyre ngjarjeve, misionarist Hibbert, ky i fundit duke folur për Ballin Kombëtar, vë në dukje se - "Balli Kombëtar" refuzoi të bënte luftë guerile (kundër pushtuesve italianë dhe më pas gjermanë). Ky ishte një vendim strategjik i tyre që nuk u ndryshua asnjëherë. Besoj se udhëheqësit e Ballit Kombëtar i kishin siguruar italianët se nuk do të krijonin

Tanja Fajon: Disa politikanë vonojnë procesin duke e politizuar atë

Liberalizimi i vizave të Kosovës, sfida për të mposhtur skepticizmin e BE-së

Hoxha: Kemi plotësuar 95 kriteret, presim që ta njohin këtë progres

Ende vijon e pazgjidhur çështja e liberalizimit të vizave në Kosovë. Autoritetet e saj janë duke i shfrytëzuar javët e fundit për të lobuar që çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën të jetë pjesë e axhendës së takimit të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian, i cili pritet të mbahet në dhjetor të këtij viti. Po ashtu, në fillim të dhjetorit, pritet që në Kosovë të qëndrojë Komisioneri për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, i cili do të diskutojë me autoritetet në Prishtinë për zbatimin e reformave për integrim në BE. Aktiviteti i shtuar i autoriteteve të Kosovës për lobim, për marrjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e vendit vjen pas skepticizmit të shfaqur nga vende të caktuara të Bashkimit Evropian për një vendim pozitiv për Kosovën lidhur me liberalizimin e vizave. Ministria e Integritimit Evropian e Qeverisë së Kosovës, Dhurata Hoxha, e cila aktualisht është në një turne lobues në disa prej vendeve të BE-së, thotë për Radion Evropa e Lirë se janë duke u bërë përpjekje që t'i bindin ato shtete që kanë hezitime për një vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën. Sipas saj, hezitimet e tilla më shumë kanë për bazë rrethanat e brendshme politike të vendeve të caktuara.

LIBERAIZIMI

Ministria e Integritimit Evropian e Qeverisë së Kosovës, Dhurata Hoxha, e cila aktualisht është në një turne lobues në disa prej vendeve të BE-së, thotë për Radion Evropa e Lirë se janë duke u bërë përpjekje që t'i bindin ato shtete që kanë hezitime për një vendim pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën. Sipas saj, hezitimet e tilla më shumë kanë për bazë rrethanat e brendshme politike të vendeve të caktuara.



DHURATA HOXHA

"Për ne është e rëndësishme që gjatë presidencës austriake të përfundojë procesi i vendimmarrjes. Kemi plotësuar një udhërrëfyes prej 95 kriteve dhe me të drejtë presim që vendet anëtare të Bashkimit Evropian ta njohin këtë progres dhe ta mbajnë fjalën e tyre për sa i përket vendimmarrjes për procesin e liberalizimit", tha Hoxha.

TANJA FAJON

"Është e papranueshme se si disa politikanë po mundohen që të politizojnë edhe më tutje procesin, duke imponuar kushte të reja dhe në këtë mënyrë të vonojnë heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës", ka thënë Fajon.

mëdha, janë më hezituese, jo për shkak të Kosovës, por për shkak të rrethanave të tyre të brendshme. Për shkak të marrëdhënieve tona të punës, komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të përditshëm që e kemi me këto shtete, nuk do të doja t'i përmend emrat, sepse ende jemi duke punuar me këto shtete që të formësojnë pozicionin e tyre për të na mbështetur.

Shpresojmë që këto pak javë që na kanë mbetur, edhe këto shtete do ta kuptojnë rëndësinë e vendimmarrjes dhe që Kosova nuk është argument që do të ndikojë në një mënyrë ose tjetër në politikë e tyre të brendshme", tha ministria Dhurata Hoxha. Lidhur me mundësinë që gjatë këtij viti të mos ketë ndonjë vendim pozitiv për liberalizimin vizave për Kosovën, ka reaguar edhe raportuesja për liberalizimin e vizave për Kosovën në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon. Në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë, ajo ka

shprehur shqetësimin për zhvillimet dhe deklaratat lidhur me liberalizimin e vizave, siç ishte ajo e kancelarit austriak, Kurz. "Është e papranueshme sesi disa politikanë po mundohen që të politizojnë edhe më tutje procesin, duke imponuar kushte të reja dhe në këtë mënyrë të vonojnë heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës", ka thënë Fajon. Ajo e ka quajtur të padrejtë faktin se janë plotësuar të gjitha kushtet nga ana e Kosovës, megjithatë Bashkimi Evropian nuk po vepron. Në anën tjetër, njohësit e integritimeve evropiane, muaj më parë kanë theksuar se zgjedhjet që do të mbahen vitin e ardhshëm në Bashkimin Evropian, do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në gjithë vendimmarrjen e BE-së, përfshirë edhe çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën. Njohësit e integritimeve evropiane kanë shprehur mendimin që pa një konsensus të shteteve të mëdha brenda BE-së, shtyrja përpara e agjendës së procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën, është e vështirë. Megjithatë, sipas tyre, autoritetet në Kosovë mund t'ua lehtësojnë vendimmarrjen të Bashkimit Evropian. Ministria e Integritimit Evropian, Hoxha, thotë se institucionet e Kosovës në përgjithësi nuk kanë hequr dorë nga kërkesa që çështja e vendimmarrjes për liberalizimin e vizave për vendin të vendoset në agjendën e

Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian. "Për ne është e rëndësishme që gjatë presidencës austriake të përfundojë procesi i vendimmarrjes. Këtë e kemi kërkuar edhe në takim me kancelarin Kurz, por gjithashtu në vazhdimësi po e kërkojmë edhe me të gjitha shtetet ku jemi duke udhëtuar. Është shumë më rëndësi që ne të vazhdojmë komunikimin me secilin prej vendeve, që t'iu tregojmë atyre që Kosova ka bërë një punë shumë të madhe. Pra, kemi plotësuar një udhërrëfyes prej 95 kriteve dhe me të drejtë presim që vendet anëtare të Bashkimit Evropian ta njohin këtë progres dhe ta mbajnë fjalën e tyre për sa i përket vendimmarrjes për procesin e liberalizimit", tha Hoxha. Sidoqoftë, që nga viti 2010, përfaqësuesit politikë dhe institucionalë të Kosovës, në vazhdimësi kanë premtuar liberalizimin e vizave për qytetarët e vendit, duke përcaktuar edhe data dhe afatet të shkurta. Megjithatë, rekomandimi pozitiv për liberalizimin e vizave nga Komisioni Evropian erdhi në korrik të këtij viti, ndërkaq votimi në favor të liberalizimit nga Parlamenti Evropian, në muajin shtator. Sfidë kryesore në këtë proces për Kosovën mbetet në Këshillin e Ministrave, ku ministrat e Brendshëm të vendeve anëtare të BE-së japin vlerësimet e tyre.

Athina në shtetrrëthim, vihen në pranga 19 persona

Sulm me molotov e lëndë kimike ndaj policisë, arrestohen ekstremistët nëpër Greqi

Mbrëmjen e të shënës Athina ka qenë nën shtetrrëthim të plotë. Policia greke arrestoi 19 persona gjatë episodeve të rënda, që zgjatën 6 orë në qendër të Athinës. Arrestimet filluan menjëherë pas demonstratës paqësore për 45-vjetorin e kryengritjes studentore të Politeknikut kundër diktaturës greke të Juntas (Hunta). Pati një luftë me molotov, lëndë kimike e sulme me



gurë e armë të ftohta në zonën e Politeknikut dhe Eksarhia, në qendër të Athinës mes policisë greke dhe antiqeveritareve e grupeve të tjera ekstremiste. Nga të dyja palët kishte të plagosur lehtë, madje janë kërcënuar edhe gazetarët. Episode ditën e shtunë pasdite dhe në vijim gjatë natës ka pasur edhe në Selanik, në Iraklio, Kretë si dhe në qytete të tjera të vendit, por më të kufizuara.



MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Infeksionet e fytyrës,
si t'i trajtoni me
bimë medicinale

DORIAN META



Ndikimi i aktivitetit
fizik te fëmijët
0-10 vjeç

ARJANA RRELI:



◆
Mjekja
psikiatre:
Dëshmitarët,
policët,
punonjësit e
urgjencës e
media më të
prekurit

Mënyrat efikase për të menaxhuar stresin post traumatik

"Ngjarjet tronditëse,
faktor kryesor i PTSD-së"

Luftoni gripin e të ftohtin me shurupin e shtogut

Mjekja psikiatre: Dëshmitarët, policët, punonjësit e urgjencës e media më të prekurit

Voltiza Duro

Arjana Rreli:

Mënyrat efikase për të menaxhuar stresin post traumatik

"Ngjarjet tronditëse, faktori kryesor i PTSD-së"

Mund të na ndodhë që të përfshihemi në ngjarje tronditëse, e madje edhe me pasoja fatale. Pas kësaj, jo të pak persona që kanë qenë dëshmitarë të ngjarjes dhe e kanë përjetuar atë, fillon të shfaqet stresi posttraumatik. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", Arjana Rreli, mjekja psikiatre me një eksperiencë 30-vjeçare në këtë fushë, e cila prej 8 vitesh punon në Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor numër 3 në Tiranë tregon mbi shfaqjen e stresit posttraumatik. Ajo thekson se kategoritë më të prekura nga PTSD janë jo vetëm dëshmitarët e ngjarjes, por edhe ata që mund ta kenë shkaktuar ngjarjen, ata që ndihmojnë viktimat ose ata që asistojnë në vendngjarje si policë, personeli i urgjencës, apo punonjësit të mediave. Më tej Rreli tregon shenjat kryesore të stresit posttraumatik si dhe mënyrat e trajtimit të tij.

Çfarë është stresi posttraumatik?

Stresi posttraumatik (PTSD) është një reaksion psikologjik, që mund të manifestohet pas një ngjarjeje traumatike. Elementet e tij specifike shfaqen papritmas dhe pa u kuptuar nga individit, ndërkohë që

tojnë në vendngjarje si policë, personeli i urgjencës, punonjësit të mediave, etj.

Cila konsiderohet ngjarje traumatike?

Konsiderohet traumatike një ngjarje që ka pasur të vdekur ose kërcënim serioz për jetën e një personi ose një grup njerëzish, si luftë, fatkeqësi natyrore, aksident në udhëtim, në punë, abuzim fizik, lajmi për vdekje të papritur jonatyrore i një personi shumë të dashur etj.

Cilat janë karakteristikat dhe shenjat e PTSD?

Një person vuan PTSD nëse ka qenë i ekspozuar ndaj traumës ekstreme, shenjat zgjasin për të paktën 1 muaj, këto shkaktojnë ankth ekstrem dhe mosfunksionim të mirë të individit. Pasja e shenjave të PTSD-së nuk do të thotë që personi është i sëmurë mendor, por që ai i përgjigjet në mënyrë normale një situatë tejet



Mjekja psikiatre, Arjana Rreli

dhe gjinia (fëmijët dhe femrat kanë më shumë risk për ta vuajtur), janë disa nga faktorët që bashkangjitur traumës, favorizojnë shpërthimin e PTSD. Problemi kryesor që shoqëron ose pason PTSD është depresioni, varësia nga alkooli, droga, ankshllitë, luhajtjet e humorit si edhe lodhje kronike, dhimbje atipike, hipertension arterial, etj. Si trajtohet stresi posttraumatik?

Trajtimi synon reduktimin e ankthit dhe rikthimin e personit në funksionim normal. Të kuptuarit dhe të pranuarit e problemit është hapi i parë për të zgjidhur problemin. Psikoterapia nuk e bën personin të harrojë ngjarjen, por e mëson atë të jetojë me atë që ka kaluar, duke e parë ngjarjen nga një këndvështrim tjetër, duke zbutur brençën që lënë kujtimet. Terapia e ekspozimit është një tjetër ndërhyrje psikoterapeutike. Ajo u kërkohet këtyre personave të përballen me situata apo elementet të traumës në mënyrë graduale, për t'u desensibilizuar nga emocionet ekstreme që i bëjnë të vuajnë. Ekspozimi mund të bëhet realisht ose me imagjinatë. Terapia e menaxhimit të ankthit, terapia njohëse dhe e sjelljes, terapia në grup, hipnoza janë disa nga ndërhyrjet e tjera që mund të ndihmojnë në kontrollin e mirë dhe të shpejtë të stresit pas traumës.

Kur rekomandohet mjekimi me medikamente?

Mjekimi zakonisht përdoret paralelisht me psikoterapiën, sidomos në personat ku dominojnë simptomat fizike, ankthi i shprehur dhe ndryshimet e humorit. Trajtimi përshkruhet përherë nga mjeku specialist, i cili kërkon kontrolle periodike dhe këshillon në kohë skemat e ndërprerjes së medikamenteve, sipas ecurisë së gjendjes. Mostrajtimi në kohë dhe në mënyrë korrekte i PTSD mund të sjellë pasojë të ndjeshme në jetën e përditshme të personit të prekur. Ai mund të ndërhyjë në punë, jetën sociale dhe familjare të personit. Kjo mund të krijojë probleme financiare, që bëhen burime stresesh të tjera.



edhe periudha e shfaqjes mund të mos ketë afërsi me ngjarjen traumatike. Sa më e ashpër të jetë trauma dhe sa më gjatë të ketë qenë ekspozimi, aq më shumë rriten shanset që personi të preket nga ky lloj stresi.

Cilat janë kategoritë më të prekura nga ky lloj stresi?

PTSD prek jo vetëm viktimat apo dëshmitarët e ngjarjes, por edhe ata që mund ta kenë shkaktuar ngjarjen, ata që ndihmojnë viktimat ose ata që asis-

stresuese. Disa nga shenjat e këtij çrregullimi përfshijnë: "flash-back" ose ripërjetimi në mënyrë të pandërgjegjshme i ngjarjes të shoqëruara me reagime të ekzagjeruara emocionale. Shpesh personi ka ndjesinë e humbjes së kontrollit, shkëputjes nga realiteti, rënies së interesave, shmangie të situatave apo elementëve që i kujtojnë traumën, etj. Shenjat e lidhura me ankthin dhe panikun janë gjithashtu të pranishme: çrregullimet e gjumit, shpërqendrimi, nervoziteti, frika, ndjenjë fajti etj. Këto

shenja duhet të zgjasin për të paktën 1 muaj.

Pse disa njerëz preken nga PTSD dhe disa të tjerë jo?

Mendohet se përgjigja e kësaj pyetjeje është kombinimi i faktorëve gjenetikë me ata të ambientit. Personat shumë të ndjeshëm, që kanë probleme të tjera psikike, që janë të vetmuar dhe pa mbështetje, janë më të pre-

dispozuar për t'u prekur nga PTSD. Gjithashtu, sa më e rëndë të jetë ngjarja dhe sa më gjatë të jetë personi i ekspozuar ndaj saj, aq më shumë rritet mundësia për të vuajtur këtë lloj stresi. Traummat e fëmijërisë, mungesa e mbështetjes shoqërore dhe ekonomike, kultura dhe arsimit, abuzimet me substancat dhe alkoolin, dëmtimet fizike, moshja

KËSHILLA PËR TË NDIHMUAR VETEN:

- ➔ Mëso për traumën dhe PTSD.
- ➔ Kalo sa më shumë kohë me familjen dhe shoqërinë.
- ➔ Përballlu me vende dhe objekte që të rikujtojnë ngjarjen.
- ➔ Fol për ngjarjen.
- ➔ Kërko ndihmë të specializuar.
- ➔ Prano dhe menaxho ankthin dhe zemërimin.
- ➔ Merr mjekimin e rekomanduar dhe zbato ndjekjen me përpikmëri.
- ➔ Bëj jetë aktive dhe të shëndetshme.
- ➔ Rezistoi tundimit për të gjetur ngushëllim tek alkooli, duhani, droga apo qetësuesit.



Mjeku popullor: Cilat janë llojet e akneve, shkaktarët kryesorë në formimin e tyre

Voltiza Duro

Lëkura jonë ka pore e gjëra dhe këto të fundit ndihmojnë në prodhimin e yndyrës. Por nëse çekulibrohet prodhimi i yndyrës, që vjen si shkak i çrregullimit hormonal, atëherë lëkura prodhon më shumë yndyrë sesa nevojitet. Më tej nga mungesa e higjienës në lëkurën e yndyrshme, ngjiten baktere dhe mikroba nga ajri dhe shkaktojnë puçra. Infeksionet bakteriale mund të merren në sallonet e bukurisë, kur përdoren furça të njëjta dhe nuk dezinfektohen nga njëri person tek tjetri. Gjithashtu, këto infeksione mund të merren kur preket fytyra me duar të palara, sidomos në ambiente publike. Ose mund të merren nga pastrimi i fytyrës me mjete të padezinfektuara. Shumë infeksione merren edhe tek dentisti, madje të gjitha llojet e kontaktit me anë të gjakut mund t'ju shkaktojnë infeksione që çojnë në formimin e puçrave. Bakteri që jeton në lëkurën e çdo njeriu i lokalizuar në rrënjën e qimeve quhet *Propionibacterium acnes* dhe ushqehet me yndyrën e lëkurës dhe qelizat e vdekura. Prandaj kur rritet yndyra në lëkurë, rritet edhe sasia e këtij bakterie në fytyrë. Ky bakter sekreton substanca që e tretin yndyrën e lëkurës dhe e ndihmojnë të rritet. Kur ky bakter shumohet më tepër sesa duhet, sistemi imunitar e lufton dhe prandaj formohen zona të inflamnuara fillimisht dhe pastaj pasi ngac-

mohen, krijojnë më shumë zona të inflamnuara. Më tej, stafilokoku është një tjetër bakter që shkakton infeksione në lëkurë dhe akne cistike, gjithashtu ai jeton në lëkurën e çdo individi.

3 nga 4 njerëz në botë janë të prekur nga aknet, nga moshë 11-30 vjeç. Disa nga llojet e akneve janë: akne cistike, akne pustule, ato papule dhe pikat e zeza apo të bardha.

LLOJET E AKNEVE:

-Pikat e zeza formohen kur bllokohen poret në lëkurë dhe ngelet nën lëkurë sebumi dhe baktere të ndryshme.



Ylli Merja

-Pikat e bardha formohen nga bllokimi i sebumit nën lëkurë dhe lëkurës së vdekur. Nuk përmban baktere pasi poret janë komplet të mbyllura, nuk ka kontakt me mjedisin e jashtëm.
-Në aknet inflamtoare, ndryshe pikat e kuqe dhe të fryra në lëkurë disa nga arsytet e krijimit të tyre janë bakteret, ndryshimet hormonale.
-Nodulet janë aknet që kanë infeksion dhe janë të inflamnuara, të fryra dhe të skuqura. Kanë rrënjë të thella nën lëkurë.
-Cistet formohen kur bllokohen poret, bakteret ngelet nën lëkurë dhe zhvillohen. Shkaktarët

Shkaqet e formimit të akneve përfshijnë bllokimin e poreve, shtesën e prodhimit të vajit sebun, bakteret, hormonet (rritja e nivelit të androgjenit në adoleshencë); dietat e pasura me shumë sheqer dhe karbohidrate. Gjithashtu edhe ushqimet me yndyrë, kontracetivët që parandalojnë shtatzëninë, konsumi i tepërt i çokolatës, steroidet që përdoren për rritjen e muskujve, produktet e qumështit (përmbajnë Bovine hormoni i rritjes) nxisin gjëndrat e yndyrës të prodhojnë më shumë yndyrë, duke nxitur aknet. Edhe stresi rrit nivelin e androgjenit në organizëm, i cili

nxit gjëndrat e yndyrës të prodhojnë më shumë yndyrë dhe kështu bllokohen poret. Gjithashtu, lëkura nuk rigjenerohet lehtë kur trupi është nën stres.

TRAJTIMI KUNDËR AKNEVE

-Vajra të fortë antibakteriale si vaj rigoni dhe vaj nga bima e çajit.

-Acidi benzoik që vret bakteret, ndalon prodhimin e sebumit.

Sulfur-antibakterial.

-Acidi salicilik, i cili ul inflamacionin, largon pikat e zeza duke i hapur poret.

-Vitamina A- retinoide, të cilat hapin poret dhe i ndihmojnë në pastrimin e tyre.

Këshilla të thjeshta

-Lajeni fytyrë 2 herë në ditë.

-Mos e prekni me duar gjatë ditës dhe largojini flokët nga fytyra.

-Përdorni 'make-up' që nuk i bllokohen poret e lëkurës.

-Mos i prekni aknet që janë në lëkurë, sepse shtohen.

-Mos përdorni shumë kafe dhe sheqer.

-Lajeni fytyrën para se të flini.

-Përdorni krem hidratant në dimër dhe krem mbrojtës në verë.

YLLI MERJA:

Infeksionet e fytyrës, si t'i trajtoni me bimë medicinale

"Përdorni vajin antibakterial të rigonit dhe vitaminën A"

Voltiza Duro

Aktiviteti fizik përgjithësisht përqendrohet te moshat e rritura, por shpesh harrojmë që edhe fëmijët kanë nevojë për aktivitet fizik. Dorian Meta, koordinator i Programeve Profesionale "Operator Fitness" tregon për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare" disa këshilla të vlefshme mbi aktivitetin fizik të fëmijët si dhe ndikimin e tij në zhvillimin psiko-motor te grupmosha 0-10 vjeç. Sipas sugjerimit të "American Academy of Pediatrics", fëmijët duhet të bëjnë aktivitet fizik jo më pak se 30-60 minuta në ditë. Kjo pasi ky aktivitet ka funksione të shumta në aspektin psiko-social dhe shëndetësor të fëmijës. Në asnjë mënyrë nuk duhet menduar që ekziston një aktivitet sportiv ideal për fëmijën, pasi janë të shumta problematikat në interpretimin e lojës sipas fazave të zhvillimit të vetë fëmijës. Arsye kjo, e cila rrit rëndësinë që fëmija të jetë ai që zgjedh lojën e tij dhe jo të jetë i induktuar nga prindi apo familjarë të tjerë. Aktiviteti duhet të jetë interaktiv, në ajër të pastër, por mbi të gjitha të ketë varietet në zhvillimin harmonik të kapacitetit motor të fëmijës. Pra, loja duhet të përshtatet me moshën e fëmijës që e luan. Aktiviteti fizik duhet të diferencohet sipas fashave të rritjes dhe grupmoshave në të cilën fëmija bën pjesë, kjo për të reduktuar stresin e fëmijës, pasi nëse luan me më të rritur, mund të krijohë aludime si i paaftë në ekzekutimin e lojës së më të rriturëve, arsye kjo që duhet të kujtojmë gjithmonë disa pika kyç në rëndësinë e zhvillimit psiko-motor sipas moshave.

- Për fëmijët nën moshën 2 vjeç duhet që prindërit të propozojnë lojëra të thjeshta dhe me pak strukturë logjike, pasi fëmija në këtë grup-



DORIAN META:

Ndikimi i aktivitetit fizik te fëmijët 0-10 vjeç



Dorian Meta, koordinator i Programeve Profesionale "Operator Fitness"

moshë humbet shpejt interesin për atë çka bëhet dhe zhvillohet.

- Fëmijët në moshën parashkollore duhet të marrin pjesë në aktivitete që lejojnë zhvillimin kreativ psikologjik, në zbulimin e hapësirë/kohës. Duhet të jenë të pakta rregullat e këtyre aktiviteteve për të mos ndërprerë vazhdimisht lojën dhe me komanda të thjeshta. Si të vraposh, të notosh apo të luash me



të krijuar një gjeneratë pozitive dhe korrekte ku vlerat trashëgohehen dhe ndihma për shokun është prioritare.

-Për fëmijët nga mosha 10-12 vjeç duhet të shtohet vëmendja tek zhvillimi i kapaciteteve motore, të jepen informacione taktike dhe strategjike për kontrollin dhe monitorimin e trupit, si dhe të aplikohen lojëra interaktive me informacione kërkimi dhe studimi edhe gjatë lojës. Të ketë aktivitet të fokusuar në zhvillimin e masës muskulore.

-Adoleshentët janë shumë të influencuar nga bashkëmoshtarët e tyre, arsye kjo që duhet zgjedhur lojëra dhe aktivitete që atyre u intereson. Të jenë në shoqëri dhe në grupe për të siguruar vazhdueshmëri të interesit, duke futur këtu edhe sportet me kompeticione. Bëhet i rëndësishëm mirëkoordinimi i figurave shoqëruese të fëmijës (familja, shoqëria, kopshiti, shkolla, etj.) për të garantuar ecuri konstante sipas moshës, por mbi të gjitha një mirëperceptim të vetvetes për të eliminuar problematika madhore, që mund të mbarten gjatë zhvillimit si depresioni, ankthi apo stresi.

top.

-Fëmijët e grupmoshës 6 deri në 9 vjeç kanë kapacitete motore më të mira dhe janë të vetëdijshëm për trupin e tyre dhe për hapësirën që zotërojnë, me ekuilibër më stabil dhe mundet të fillojnë sporte të organizuara me rregulla fleksibël, ku pikësynimi dhe fokusi duhet të jenë në aspektin e kënaqësisë së në atë të kompeticionit. Është një hap themelor ky për

Këshilla



Luftoni gripin e të ftohtin me shurupin e shtogut

Çajrat bimorë përbëjnë kurën më të mirë natyrale kundër shumë problemeve me shëndetin. Çaji i kamomilit rekomandohet gjerësisht kundër urthit dhe stresit, ndërsa çaji i xhenxhefillit ose nenexhikut rekomandohet kundër problemeve me stomakun. Në vendin tonë ka nisur zyrtarisht stina e virozave dhe mjekët raportojnë një numër në rritje të pacientëve që janë prekur nga virozat në rrugët e sipërme të frymëmarrjes. Një nga bimët më të mira kundër këtyre problemeve është shtogu, në formë çaji apo shurupi. Të gjitha këto e furnizojnë trupin me antioksidantë dhe forcojnë sistemin imunitar. Studime të ndryshme kanë konfirmuar se marrja e 15 ml shurup shtogu katër herë në ditë zvogëlon kohëzgjatjen e simptomave të gripit me të paktën 4 ditë. Ky shurup zbut ashpërsinë e simptomave të të ftohurës. Në treg mund të gjeni marka cilësore të këtij shurupi, ose mund ta përgatitsni vetë atë në kushtet e shtëpisë.

Shurup shtogu i bërë në shtëpi ka këto përbërës: 3 gota e gjysmë me ujë të ftohtë, 2 gota me kokrra të thata shtogu, 1 lugë gjelle me copa xhenxhefilli organik të freskët ose të thatë, 1 lugë çaji me kanellën pluhur ose 1 shkop kanelle, 1 filxhan me mjalte cilësor. Hidhni ujin në një tenxhere dhe shtoni kanellën, kokrrat e shtogut dhe xhenxhefillin. Lëreni lëngun të ziejë. Uleni zjarrin dhe mbajeni tenxheren të mbuluar, ndërsa lëngu zien për

40-45 minuta deri sa sasia e lëngut të përgjysmohet. Hiqeni tenxheren nga zjarri dhe shtypini kokrrat. Përdorni një napë të pastër ose kullësë dhe lëngun hidhni në një enë qelqi. Nëse përdorni napën, mos hezitoni ta shtrydhni atë që të përftoni lëngun e mbetur. Shtoni mjalte dhe përziejeni deri sa të jetë tretur. Shurupin hidhni në një shishe ose enë qelqi të sterilizuar dhe ruajeni në një vend të freskët. Konsumoni nga një lugë gjelle shurup shtogu tri herë në ditë për rreth 15 ditë.



5 efektet e mrekullueshme të lules së pasionit

Lulja e pasionit apo Passiflora është e njohur për vetitë e saj qetësuese. Në grupin e kësaj luleje bëjnë pjesë 500 specie të ndryshme të familjes Passiflora. Ekspertët kanë identifikuar pesë vlera kryesore të lules së sahatit për shëndetin e njeriut.

1. Lulja e pasionit ul tensionin e gjakut
Shkencëtarët besojnë se një përbërë kimik i lules së sahatit që quhet acidi edulilik ndihmon në uljen e tensionit të gjakut. Tuli i frutit të lules së sahatit është një kurë e mirë për uljen e tensionit. Ky efekt ndihet pas përdorimit të 8 miligramëve të lules së sahatit për një periudhë pesëditore. Rezultatet shkencore kanë treguar se ekstrakti i lules së sahatit rrit nivelet e një enzime të caktuar, që luan rolin e antioksidantit dhe ul nivelet e lipideve të oksiduara që shkaktojnë dëme të shumta, duke akumuluar toksinat e rrezikshme në trup.

2. Për një gjumë më të qetë
Një nga përdorimet më të zakonshme të çajit ose ekstraktit të lules së pasionit në mjekësi është kundër pagjumësisë. Gjatë studimeve të kohëve të fundit, shkencëtarët kanë arritur në konkluzionin se konsumi i dozave të vogla të çajit të lules së sahatit ofron përfitime afatshkurta tek të rriturit që vuajnë nga pagjumësia.

3. Lehtëson dhimbjet
Lule sahati ka një efekt qetësues dhe zbeh kontraktimet. Rrjedhimisht, lulja e pasionit ndihmon në uljen dhe zbutjen e dhimbjeve fizike. Këtë lule mund ta konsumoni nëse vuani nga dhimbjet menstruale, apo për të ulur dhimbjen e kokës. Lulja e pasionit mundet të ndihmojë edhe në lehtësimin e kontraktimeve të muskujve dhe dhimbjes së dhëmbëve.

4. Ndihmon kundër stresit dhe ankthit
Lulja e pasionit përdoret gjerësisht kundër acarimeve nervore, ankthit dhe stresit. Në ndryshim nga medikamentet më të përdorura kundër këtyre shqetësimeve, lulja e sahatit nuk ka efekte anësore (trullosje, drobitje), ose nuk lë pasojë në punën tuaj ditën e nesërme.

5. Kundër depresionit
Pjesëmarrësit e një studimi të huaj konsumuan suplemente të lules së pasionit çdo ditë për një periudhë gjashtë mujore. Ata nisën të ndiheshin mirë që në javën e tretë. Shkencëtarët arritën në konkluzionin se lulja e pasionit ofron avantazhe për femrat e prekura nga menopauza. Megjithatë, mjekët këshillojnë që njerëzit të mos e konsumojnë lulen e sahatit, nëse marrin ilaçe të rekomanduara kundër depresionit apo stresit.

KONCERTI

Portret në tinguj i një kompozitori

Dr. Holta Sina Kilica

Në kuadër të aktivitetit 'Balcan Contemporary Music Festival', ACA (Shoqata e Kompozitorëve Shqiptarë) organizoi para pak ditësh, në sallën e koncerteve të Universitetit të Arteve, një koncert-portret dedikuar kompozitorit dhe pedagogut të mirënjohur të kompozicionit dhe harmonisë prof. Thoma Gaqi.

Th. Gaqi është një ndër kompozitorët më origjinalë dhe të veçantë të brezit të dytë të kompozitorëve shqiptarë dhe një prej personaliteteve e rëndësishëm me ndikim në muzikën dhe kulturën shqiptare. Si nxënës i të madhit Ç. Zadeja, ai dëshmoi që gjatë viteve të shkollimit akademik talent të spikatur dhe prirje të theksuar në drejtim të muzikës instrumentale-simfonike. Veprat e krijuara gjatë kësaj periudhe si koncerti për violinë (3 kohë) dhe Poema simfonike Borova (punë diplome) u pasuan më tej në vite nga një sërë krijimesh të tilla si Poemë-koncerti për violinë e orkestër, koncerti për violonçel e orkestër, Dubël-koncerti (rapsodia) për violinë, violonçel e orkestër, koncerti për harqe (3 kohë), tri vallet simfonike, një simfoni, Scherzo për orkestër etj.

Këto vepra të përmasave të mëdha kanë hyrë me dinjitet në fondin e literaturës sonë më të mirë muzikore. Pikërisht me një stil të pangatërrueshëm, Th. Gaqi veçohet për kompleksitetin e marrëdhënieve melo-harmonike, mbivendosjen tingëllore (intervalore), përdorimin dhe ndërthurjen e veçantë të modo-tonalitetit etj., si dhe për mbështetjen në elementet melo-ritmikë e intonativë të folktraditës sonë.

Portreti i tij u skicua në këtë mbrëmje, përmes veprave të kompozuar për muzikën e dhomës, që megjithëse nuk zënë atë hapësirë që rrokjin veprat instrumentale-simfonike në opusin e tij krijues, është padyshim një pjesë cilësore e identitetit të tij si kompozitor.

Programi i koncertit, i konceptuar me kujdes, solli para publikut dy pamje të krijimtarisë së tij, që përkujtojnë me dy etapa krijuese: para dhe pas viteve '90. Pikërisht



“
Th. Gaqi është një ndër kompozitorët më origjinalë dhe të veçantë të brezit të dytë të kompozitorëve shqiptarë dhe një prej personaliteteve e rëndësishëm me ndikim në muzikën dhe kulturën shqiptare.

pesë veprat e përzgjedhura që u interpretuan në këtë natë ishin radhitur duke alteruar një vepër të para '90 me atë të pas '90.

Veprat u interpretuan nga pedagogët e Universitetit të Arteve, që janë njëkohësisht dhe koncertistët më në zë në skenën shqiptare.

Dy vallet simfonike nr. 1 dhe nr. 2 (krijime të vitit 1981), të përshatatura për katër duar nga vetë autori, erdhën nën interpretimin kualitativ të pianisteve Merita Rexha dhe Fatma Spahiu. Efektet dhe dinamika që përcuan këto valle krijuan një atmosferë të gjallë dhe elektrizuese në sallë, veçanërisht me vallen nr. 2, të mirënjohur si 'Vallja me dajrë' ose 'Boloroja shqiptare', që megjithëse në një temp më të ngadalshëm, nuk e humbi impaktin që krijon në publik sa herë që interpretohet.

Mes këtyre dy valleve dhe menjëherë pas tyre u interpretuan pikërisht dy veprat e krijuara pas viteve '90: 'Kadenca për violë solo' (krijim i vitit 1999) interpretuar nga Arben Llozi dhe ASCHEDIS -trio për klarinetë, violë dhe piano me tri kohë (krijim i vitit 2001), interpretuar nga F. Qerimaj (klarinetë), Arben Llozi (violë) dhe Merita Rexha (piano).

“
Nxënës i të madhit Ç. Zadeja, ai dëshmoi që gjatë viteve të shkollimit akademik talent të spikatur dhe prirje të theksuar në drejtim të muzikës instrumentale-simfonike.

Këto vepra dëshmuuan tendencat dhe evoluimin e gjuhës kompozicionale të Th. Gaqit pas viteve '90, por pa dalë gjithësesi nga ADN-ja e tij.

Reflektimet e këtyre tendencave të reja të autorit u shfaqën ndjeshëm në lojën e pjekur e shumëplanëshe të A. Llozit tek 'Kadenca', ndërsa në trion ASCHEDIS, kantilenës së ngrohtë dhe legatos së klarinetës të F. Qerimajt fillimisht iu përgjigj loja impulsive e violës së A. Llozit dhe mbështetja energjike e pianos së M. Rexhës. Secila kohë kishte pamjen e saj, me linjat e pavarura të secilit instrument, por dhe me unifikimin e soliditetin në momente të ndryshme. ASCHEDIS (e cila ka kuptimin e notave bazë, mbi të cilat ndërtohet linja e fillimit të veprës nga viola: lab, do, si, mi dhe re#) është një ndër veprat e muzikës së dhomës më të luajtura të kompozitorit edhe në skenat ndërkombëtare.

Vepra që e përmbylli këtë natë koncertore ishte koncerti për orkestër harqesh me tri kohë (krijim i vitit 1985), i cili erdhi nën interpretimin e orkestrës së harqeve të studentëve të Universitetit të Arteve (me pjesëmarrje edhe të disa pedagogëve të tij) nën drejtimin e dirigjentit Artan Liçaj. Ky koncert është një ndër veprat më të mira të repertorit shqiptar për orkestër harqesh, vepër e cila krijoi një tablo të gjallë e tepër dinamike në kohët anësore mbështetur në tonusin kombëtar dhe një tjetër atmosferë të një natyre sa të qetë, të përmbytur aq edhe të dhimbshme në kohën e dytë - një nga materialet muzikore më të bukura të autorit. Është për t'u vlerësuar loja impresionuese e dy solistëve (pedagogë të UA) Lorenc Radovani (violinë) dhe Astrit Selita (violonçel) të cilët ishin edhe promotorët e orkestrës së harqeve.

Ky koncert-portret ishte një dedikim shumë i veçantë për punën dhe krijimtarinë e kompozitorit Thoma Gaqi, një nderim i cili shpresojmë se do të vijojë në të ardhmen edhe për të tjera figura e personalitete të krijimit e interpretimit muzikor shqiptar.

*Muzikologe, pedagoge në Universitetin e Arteve

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Opinion i Ditës

Dyfishim investimesh apo dhjetëfishim problemesh?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... duket si lajm i mirë. Po dyfishojmë investimet publike. Sa mirë, vërtet! Mirëpo, edhe pse si qytetar gëzojmë nga ky lajm, si ekonomist nuk arrij dot. Kjo, ngaqë si koncesionet, ashtu edhe kontratat me qasjen PPP mbartin një ajnsberg me probleme, nëse nuk qeverisen me ndershmëri, përkushtim e profesionalizëm. Në kushtet e vendit tonë, ky ajnsberg shndërrohet në Everest, në një mal të lartë. Po pse? Janë dhjetë arsye për zhvillime tejet shqetësuese në të ardhmen e financave tona publike, me dyfishimin e koncesioneve dhe kontratave PPP që qeveria jonë ka ndërmend të kryejë. Së pari, qeveritë tona që nga viti 2007 e deri tani kanë dhënë kontrata koncesionare tejet të favorshme për biznese të caktuara vendëse (kryesisht mike qeveritarësh firmues kontratash apo kompani me pozicion mbizotërues në treg) dhe zhvilluar tendera jokonkurresive për shumicën dërrmuese të sipërmarrjeve private vendëse dhe të huaja. Së dyti, ka ndodhur rritje e paargumentuar e shpenzimeve prodhuese ose kostove të shërbimit PPP, për shkak të shmangies së pagesës së taksës mbi fitimin, si dhe rëndim të çmimit fundor mbi konsumatorin ose mbi Buxhetin e Shtetit (sikurse rasti i Partneriteve Publik-Privat në shëndetësinë publike, si "Check-up" (kontrolli falas për moshat 40-65 vjeç), sterilizimi i pajisjeve spitalore (grupi i instrumenteve kirurgjikale), hemodializa). Së treti, kemi pasur zgjatje të afatit të koncesioneve tej çdo limiti kohor. Së katërti, kemi pasur rëndom ndryshim të kriterëve të përzgjedhjes së kompanisë fituese nga ato që i ofrohen publikut shqiptar, apo në shtypin e huaj, me ato në dokumentet e tenderimit. Së pesti, kemi mosarëkitim të garancisë bankare nga koncesioni i dështuar (rasti i privatizimit të dështuar të "Albpetrol"-85 milionë euro ende të paarkëtuara në Buxhetin e Shtetit). Së gjashti, kemi afate tejet të shkurtra të shpalljes së ftesave të projekteve koncesionare (praktika botërore i ka mesatarisht 2 vjet; tek ne ka ndodhur shpallja edhe brenda disa javëve!). Së shtati, kemi mungesë të plotë dhe kronike të diskutimit paraprak publik për të gjitha koncesionet e dhëna deri tani dhe për Partneritet Publik-Privat që kemi dhënë ose do të japim, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të FMN-së, Bankës Botërore dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit për transparencë. Së teti, kemi mungesë të strategjive të zhvillimit për sektorët specifikë ku jepet koncesioni apo Partneriteti



Publik-Privat, si dhe kontrata koncesionare ose PPP të përgatitura shumë keq, pa tërhequr vëmendjen dhe interesin masiv të kompanive të sektorit apo të kompanive të huaja nga vendet aleate strategjike tonat (Gjermani, Itali, etj.). Së nënti, kemi futje të formave të pazakonta të Partneritetit Publik-Privat (rasti i ndërtimit të 17 shkollave të sistemit parauniversitar në Bashkinë Tiranë, për 6.2 miliardë lekë), duke përdorur si mjet financimi taksa anormale të përkohshme mbi arsimin, duke shmangur konkurrencën në treg dhe duke rritur për-

fitueshmërinë e pamerituar të lobeve të biznesit dhe koston e ndërtimit të objekteve shkollore në fjalë (sipas një eksperience të ngjashme kroate në Bashkinë e Zagrebit, të konstatuar nga institucioni i auditimit të jashtëm të këtij vendi, kjo kosto aty u rrit mbi 6 herë). Së dhjeti, mospërfshirja e pagesave të Buxhetit të Shtetit për PPP-të në llogaritë e borxhit publik sjell shifra të deformuara të këtij të fundit, duke fshehur rreziqet e vërteta që u kanosen financave tona publike. Këto pagesa për tri vitet e ardhshme 2019-2021 do të jenë mesatar-

isht rreth 50 milionë euro në vit. Nëse ato do të përfshiheshin (sikundër është edhe orientimi i BE-së dhe rekomandimi i Gjykatës Evropiane të Auditesve) në përlllogaritjet e borxhit tonë publik, së bashku me detyrimin për rimbursimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe faturat e prapambetura (vetëm për vitin 2017, detyrimi për rimbursimin e TVSH-së ishte 88 milionë euro, ndërsa detyrimet e prapambetura ndaj biznesit për punë të kryera për llogari të shtetit ishin 152 milionë euro), atëherë mburrjes së sotme qeveritare se kemi ulur borxhin publik do t'i binte gjethi dhe do të dilte lakuriq e vërteta se ky borxh po rritet kërcënueshëm. Ja përse këto dhjetë arsye i rrisin dhjetëfish problemet me koncesione dhe PPP-ve dhe nuk gëzojmi dot me dyfishimin e investimeve publike në këto forma. Ja përse ky katarakt koncesionesh dhe PPP-esh po i ngjan një epidemie që ka rënë sot jo vetëm në ekonominë publike të vendit, por që shpejt pasojat negative të së cilës do t'i ndiejmë edhe në ekonominë vetjake të gjithsecilit prej nesh.

Mospërfshirja e pagesave të Buxhetit të Shtetit për PPP-të në llogaritë e borxhit publik sjell shifra të deformuara të këtij të fundit, duke fshehur rreziqet e vërteta që u kanosen financave tona publike. Këto pagesa për tri vitet e ardhshme 2019-2021 do të jenë mesatarisht rreth 50 milionë euro në vit.

HOROSKOPI

DASHI

Buzëqeshja është përgjigjia e duhur ndaj problemeve. Mos shpenzoni shumë vetëm për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve. Mbrëmjet me miqtë do të jenë shumë të këndshme. Ndërkohë, do të bëni plane për disa pushime të shkurtra.

DEMI

Shmangni ndjesitë negative si frika, inati etj. Përmirësimi i të ardhurave do t'ju bëjë që të pagani disa borxhe, që ju mundojnë prej kohësh. Partneri/partnerja juaj do t'ju ndjejë shumë mungesën gjatë ditës së sotme.

BINJAKET

Përpikuni të shmangni stresin duke kryer aktivitete interesante. Mos merrni vendime të nxitura, sidomos kur bëhet fjalë për çështje financiare. Shëndeti i bashkëshortit/bashkëshortes suaj mund t'ju shqetësojë.

GAFORJA

Duhet të mos tregoheni më kokëfortë nëse dëshironi një jetë të lumtur. Përgjegjësitë familjare do t'ju rriten, çfarë do t'ju shkaktojë tension. Ka gjasa që të mërziteni për shkak të ndërhyrjeve të anëtarëve të familjes apo të bashkëshortes/bashkëshortit.

LUANI

Ka gjasa të përballemi me disa probleme sot, por bëhuni realiste dhe mos prisni mrekulli nga njerëz që përgjigjen t'ju ndihmë. Mos lejoni që të jërë të kuptojnë sesi ndihesh. Bashkëshorti/bashkëshortja do t'ju kushtojë vëmendje të veçantë sot.

VIRGJERESHA

Është dita e duhur për t'u kushtuar kohë personave me të cilët nuk je takuar prej kohësh. Mos e zhgënjëni partnerin/partneren sot, pasi do të pendoheni më pas. Ka gjasa të realizoni një udhëtim, i cili do t'ju prezantojë me vende dhe miq të rinj.

PESHORJA

Mund të çlirohemi nga një sëmundje afatgjatë. Mos flisni rreth investimeve dhe qëllimeve për të ardhmen. Punoni fort për mirëqenien e familjes. Mund të nisni një marrëdhënie të re romantike, e cila do t'ju bëjë të ndiheni mjaft mirë.

AKREPI

Është koha e duhur të kërkonin ndihmë nga një personi i afërt me të cilin mund të bisedoni hapur. Kjo do t'ju ndihmojë pa masë në shmangien e stresit. Duhet të relaksoheni dhe të gjeni lumturinë përkatëse familjare dhe miqve të ngushtë.

SHIGJETARI

Bëni kujdes me regjimin ushqimor, veçanërisht personat e kësaj shenje që vuajnë nga migrena. Ka gjasa që të fitoni mjaftueshëm të ardhura sot. Mos fantazoni shumë dhe përpikuni të bëhuni më realiste.

BRICJAPI

Mund të ndiheni të shqetësuar për shkak të shëndetit. Duhet ta kaloni këtë gjendje sa më shpejt të jetë e mundur që të rifitoni lumturinë në familje. Bëni shumë kujdes me transaksionet financiare.

UJORI

Emocionet dhe pasioni i tepërt mund të dëmtojnë sistemin nervor. Mbani veten nën kontroll për ta shmangur një situatë të tillë. Ngërçin financiar që iu ka përfshirë do ta kaloni me ndihmën e miqve.

PESHQIT

Pavarësisht se do të kaloni një ditë të mbushur plot aktivitete të ndryshme, nuk do të ndiheni aspak të lodhur. Përpikuni të mos bëni shpenzime të tepërta. Sot është dita kur mund të përfjetoni vetëm anëtarë pozitivë të martesës.

Opinion i Ditës

Mendimi në prag të 'Luftës së Madhe'...

Nga Përparim Kabo

(vijon nga faqja 1)

... në luftë u përpoqën të justifikoheshin se kishin luftuar për të mbrojtur atdheun dhe interesat e tij. Në fakt, ky ishte një shfaqje e qortë dhe të daraviste përgjegjësitë. "Lufta jo vetëm që shkatërroi pjesën më të madhe të trashëgimisë europiane si dhe miliona njerëz të saj, por ajo egërsi dhe shumë prej atyre që mbijetuan. Pasionet nacionaliste... çuan gjithashtu në vrasje mizore të civilëve, qoftë nga gjermanët në Belgjikë, rusët në Galici, apo austriakët në Bosnjë... Pas luftës, në pjesën më të madhe të Europës, politikat karakterizohen nga dhuna, me vrasje të shpeshta dhe beteja jo të ndershme midis partive opozitare. Ideologjitë e reja totalitariste si fashizmi dhe komunizmi i stilit rus e nxorën organizimin dhe disiplinën e tyre nga ushtarakët dhe në rastin e fashistëve, ata frymëzimin e tyre e morën nga vetë lufta". Si edhe u parashikua në Konferencën e Paqes në Paris në 1919 - pas 20 vitesh do kishte luftë sërish. Dhe ashtu ndodhi. Nga kjo panoramë dritësohet një fakt, njerëzit që e çuan botën në Luftë të Parë Botërore me vendimmarrjen apo me mosveprimin e tyre, a mund të ndaleshin? Shkencaat si antropologjia, filozofia, sociologjia, psikologjia, por edhe artet, kultura pse u treguan kaq të pafuqishme. A mos vallë nuk e kuptonin se çfarë po ndodhte, nuk mundeshin, apo e ishin të pazonjakt?

Më ka ngacmuar gjithnjë fakti që në prag të 'Luftës së Madhe', mendimi ishte në një vlag zhvillimi dhe përmbyesjes, pra duke qelqur ushqenit një shoqëri të paqes dhe prosperitetit, porse nuk mundte pra së paku t'u thoshte njerëzve, civilizimit të kohës, se këta "burra shteti" që drejtojnë po na shpënin në luftë. As një ngjarje e rëndësishme në historinë botërore, aq më tepër një luftë e këtyre përmasave, nuk mund të vijë një ditë krejt papritur në pragun e njerëzimit pa parahistorinë e vet. Si po zhvillohej mendimi në prag të "Luftës së Madhe". "Historia e njerëzimit është pjesë përbërëse e historisë së natyrës" shkruante Edward Tylor, i cili është një nga baballarët e antropologjisë moderne... dhe mendimet tona, vullnetet dhe veprimet përputhen me ligjet po aq të përcaktuara sa ato që drejtojnë lëvizjet e dallgëve, kombinimin e acideve dhe bazave si dhe rritjen e bimëve dhe të kafshëve". Ky besim në shkencë quhej pozitivizmi... Edward Burnett Tylor (2 tetor 1832-2 janar 1917) ishte një antropolog anglez, themeluesi i antropologjisë kulturore. Ide të e Tylorit karakterizojnë evolucionizmin kulturor të shekullit të 19-të. Në veprat e tij, "Kultura Primitive" (1871) dhe "Antropologjia" (1881), ai përcaktoi kontekstin e studimit shkencor të antropologjisë, bazuar në



teoritë evolucionare të Charles Lyell. Ai besonte se kishte një bazë funksionale për zhvillimin e shoqërisë dhe fesë, të cilën ai e përcaktonte se ishte universale. Tylori pohonte se të gjitha shoqëritë kaluan nëpër tri faza themelore të zhvillimit: nga egërsia, përmes barbarizimit në civilizim. Tylori është një figurë themelore e shkencës së antropologjisë sociale dhe veprat e tij shkencore ndihmuan në ndërtimin e disiplinës së antropologjisë në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe fillim shekullin XX. Ai besonte se "hulumtimet në historinë dhe parahistorinë e njeriut... mund të përdoren si bazë për reformën e shoqërisë...". Tylori rimori sërish termin animizim (besim në shpirtin individual ose anima e të gjitha gjërave dhe manifestimet natyrore) në përdorim të përbashkët. Ai e konsideronte animizmin si fazën e parë të zhvillimit të feve. Evolucionizmi dallonte nga një besim tjetër, difuzionizmi, duke përcaktuar përhapjen e kulturës nga hapësirat e inovacionit. Nacioni i kulturës të Tylori përshkruhet më së miri në veprën e tij më të famshme, "Kultura Primitive" me dy vëllime. Vëllimi i parë, titullohet "Origjina e Kulturës" dhe trajton etnografinë duke përfshirë: evolucionin social, gjuhësinë, mitin. Vëllimi i dytë, titullohet "Feja në Kulturën Primitive" dhe merret kryesisht me interpretimin e animizmit.

Kultura ose qytetërimi, marrë në kuptimin e saj të gjerë etnografik është ajo tërësi, e cila përfshin: njohuri, besim, art, moral, ligj, zakon çdo aftësi dhe zakone të tjera të fituara nga njeriu si anëtar i shoqërisë. Në 1881 Tylor botoi një vepër të quajtur "Antropologji", (për antropologjinë kishte folur edhe Aristoteli dhe Kanti) një nga të parat me atë emër. Në kapitullin e parë ai theksoi atë që do të bëhej një lloj deklarate kushtetuese për fushën e re, të cilën ai nuk mund të dijë dhe nuk kishte ndërmend

në atë kohë: "Historia, për aq sa ajo kap nga e shkuara, tregon artet, shkencat dhe institucionet politike që fillojnë në shtete të varfra dhe bëhen në rrjedhën e epokave, më inteligjente, më sistematike, më të rregulluara ose të organizuara, për t'u përgjigjur qëllimeve të tyre". Tylori argumentoi se njerëzit e kishin përdorur fenë për të shpjeguar gjërat që ndodhën në botë, se animizmi është thelbi i fesë, se ai përshkruhet si besimi në shpirtit që banojnë dhe animojnë geniet, ose shpirtit ekzistues të gjërave. Sipas tij, fakti që praktikuesit fetarë modernë vazhduan të besonin të shpirtit tregonte se këta njerëz nuk ishin më të avancuar se shoqëritë primitive. Për të, kjo nënkuptonte se praktikuesit fetarë modernë nuk i kuptojnë mënyrat e universit dhe se si funksionon vërtet jeta, sepse ata e kanë përjashtuar shkencën nga kuptimi i tyre i botës. Tylori e perceptoi besimin fetar modern në Zot si një "mbijetesë" të injorancës primitive. Megjithatë, Tylori nuk besonte se ateizmi ishte fundi i logjikës së zhvillimit kulturor dhe fetar, por në vend të tij pranonte një formë shumë minimalistike e deizmit monoteist. Kështu, Tylori paraqiti një përshkrim antropologjik të "eliminimit gradual të paganizmit" dhe zhgënjimit, por nuk mbërriti të sekularizimit.

Në 1871, Tylor botoi "Kulturën Primitive", duke u bërë iniciator e antropologjisë kulturore. Metodën e tij ishin etnografia krahasuese dhe historike. Ai besonte se një "uniformitet" ishte manifestuar në kulturë, e cila ishte rezultat i "veprimit të njëtrajtshëm të shkaqeve uniforme". Ai i konsideronte shembujt e tij të koncepteve dhe praktikave etnografike paralele si tregues të "ligjeve të mendimit dhe veprimit njerëzor", evolucionist. Për këtë arsye, detyra e antropologjisë kulturore, sipas tij është të zbulojë "fazat e zhvillimit apo evolucionit". Por ja që lufta tregoi se e ndalon zhvillimin evol-

utiv, ndalon rrjedhat dhe e nxjerr instinktin shpagues në fushat e betejës. Vetëm në betejën e Verdun-it u vranë po thuaj 1 milion burra. Shpesh studiuesit iu kthehen shifrave dhe ato gjithnjë kanë ardhur duke u shtuar: Luftimet u zhvilluan nga 21 shkurt deri më 18 dhjetor 1916. Ishte beteja më e madhe dhe më e gjatë e Luftës së Parë Botërore Frontin Perëndimor midis ushtrive gjermane dhe franceze. Në fushën e filozofisë, në fundshekullin XIX dhe fillimshekullin XX dallohet Herbert Spenceri si filozofi më i lexuar në atë kohë... i cili argumentonte se "ligjet e evolucionit zbatoheshin në shoqëritë njerëzore po ashtu si zbatoheshin te speciet...". Spencer zhvilloi një koncept gjithëpërfshirës të evolucionit si zhvillim progresiv të botës fizike, organizmave biologjikë, mendjes njerëzore, kulturës dhe shoqërive njerëzore. Si një studiues shumëplanësh, ai kontribuoi në një gamë të gjerë lëndësh, duke përfshirë etikën, religjionin, antropologjinë, ekonominë, teorinë politike, filozofinë, letërsinë, astronominë, biologjinë, sociologjinë dhe psikologjinë. Gjatë jetës së tij, ai arriti një autoritet të jashtëzakonshëm, kryesisht në botën akademike anglishtfolëse. "Filozofi i vetëm anglez që ka arritur një popullaritet kaq të përhapur ka qenë Bertrand Russell dhe kjo do të ndodhte në shekullin e 20-të". Spencer ishte "intelektuali i vetëm evropian më i famshëm në dekadat e fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë", i njohur për shprehjen "mbijetesë e më të fortit", të cilën ai e formuloi të studimi tij "Parimet e Biologjisë" botuar në 1864, pas leximit të Çarls Darwinit mbi origjinin e specieve. Ky term sugjeron fuqishëm përzgjedhjen natyrore, ndërsa Spenceri e zgjeroi evolucionin në sfera sociologjike dhe etike.

Libri i dytë i Spencerit, "Parimet e Psikologjisë", botuar në 1855, e hulumtoi nga bazat fiziologjike

psikologjinë. Spenceri synonte të pajtonte psikologjinë shoqërore me atë të 'Logjikës' së John Millit dhe më tej me nocionin se mendja njerëzore u ndërtua nga ndjesitë atomike të mbajtura së bashku nga ligjet për shoqërimin e ideve, si dhe dukshëm me teorinë shkencore të frenologjisë, e cila lokalizon në mënyrë specifike funksionet mendore me pjesët e trurit. Psikologjia, besonte ai, do të bënte për mendjen njerëzore atë që Isak Njutoni kishte bërë për lëndën. Spencer jetoi gjatë një periudhe që koïncidonte me ngritjen dhe rënien e liberalizmit politik - ose atë që Spencer e quajti liberalizëm të vërtetë, dhe që sot njihet si liberalizmi klasik. Kjo filozofi politike, e cila kishte bërë hapa të mëdhenj për të sjellë liri më të madhe individuale në fe, tregti, fjalim dhe zona të tjera... Duke e parë zhvillimin si një formë e re të organizimit shoqëror, "bashkëpunimi vullnetar" i krijuar mbi një "regjim të kontratës", që zëvendësoi pjesën më të madhe të një forme më të vjetër të organizimit shoqëror bazuar në "bashkëpunim e detyruar" si një regjim statal. Kur Spencer botoi "Njeriun kundrejt shtetit" në 1884, ai argumentoi se "liberalizmi i ri e kishte braktisur parimin e tij original qendror që mbështeste lirinë individuale kundrejt shtetëritë të shtetit". Spencer e shihte këtë mosmarrëveshje si një dallim, por pa një ndryshim thelbësor: "Çështja e vërtetë është nëse ndërhyhet më shumë në jetët e qytetarëve. "Një person nuk është më pak i detyruar dhe të drejtat e tij nuk janë më pak të shkelura thjesht sepse kufizimet e padrejta në liritë e tij vendosen nga një shumicë, (parlamentare) më shumë sesa nga një sundues i vetëm dikur (mbret). Dhe ashtu ndodhi, parlamentet votuan për kreditimet e luftës. Por në beteja dhe në trashen e luftës vritet njeriu, individ.

Në vitin 1900 Europa ishte kurrë ndryshe nga një shekull më parë, më e begatë dhe shumë më e qëndrueshme... në këtë vit hapet ekspozita e madhe e Parisit, në të cilën u zhvilluan 130 evente, ku përfshihen: diskutimet mbi gjendjen dhe të drejtat e grave, socializmin, shuarjen e zjarreve, vegjetarizmin, filozofinë. U zhvillua kongresi i 9 universal i paqes, i cili fitoi dhe çmimin e madh të ekspozitës së Parisit. Shkrimtari, dramaturgu dhe gazetari i shquar austriak Stefan Zweig shkruante: "E për çfarë do të ndërprej kjo rritje, kush do t'ia zinte udhën energjisë që nxirrte vazhdimisht fuqi të reja prej hovit të saj? Europa nuk kishte qenë kurrë më e fortë, më e pasur, apo më e bukur, kurrë nuk kishte besuar me më zjarr për një të ardhme më të mirë". Është më rëndësi arsyetimi që bëjnë profesora Margaret MacMillan në studimin e saj të thellë titulluar "Lufta që i dha fund paqes", kur shprehet: "Ne duhet të përpiqemi të kuptojmë ata njerëz të një shekulli më parë... se çfarë kishin në

mëndje, çfarë u thoshte mendja, çfarë kishin frikë, apo çfarë shpresonin dhe cilat ishin hamendësimet e tyre të pashprehura, bindjet dhe vlerat, për të cilat ata nuk shqetësoheshin që t'i diskutonin, sepse i kishin të njëjta? Përse nuk i panë rreziqet që po grumbulloheshin rreth tyre në vitet drejt 1914-s? Nga fundi shekullit 19-të, fillimshekulli 20-të kishin dy bindje të dallueshme përparimi dhe pozitivizmi... Ideja ishte se shkenca mund të zgjidhte problemet, por nocione të tilla gjithmonë sulmoheshin. Albert Einstein dhe fizikanët të tjerë po diskutonin për grimcat atomike dhe ato nënatomike dhe po sillnin përmbysje me kahje mosparashkueshmërinë si dhe dyshimin në lidhjen shkak-pasojë... Ishte vënë në diskutim realiteti dhe racionaliteti. Psikologët dhe sociologët mëtonin se njerëzit ndikoheshin më shumë nga forcat e nënvetëdijës se sa ishte hamendësuar... Në Vjenë u botua libri i Sigmund Freud (1900 në të njëjtin vit të ekspozitës) "Interpretimi i ëndrrave". Eksplorimi i pafund i Freud për të pandërgjegjshmen nëpërmjet ëndrrës është dhënë qartë dhe saktësisht. Duke përfshirë dhjetëra raste konkrete dhe analiza të detajuara të ëndrrave të vërteta. Interpretimi i ëndrrave mbetet një mjet i paqmar për të na ndihmuar që të gjithë të zbulojmë të vërtetën për veten tonë.

Koha mbajti si të sakta shumë nga përfundimet e tij. Zbulimi i Freud se ëndrra është mjeti me të cilin mund të hulumtohet e pandërgjegjshmja është padyshim hapi më revolucionar përpara në tërë historinë e psikologjisë. Ëndrrat, sipas teorisë së tij, përfaqësojnë përmbushjen e fshehtë të dëshirave tona të pandërgjegjshme. Freud paraqiti në punimin e tij shumë koncepte kyçe, që më vonë do të bëheshin thelbësore në teoritë e psikoanalizës. Ëndrrat, sugjeroi ai, janë dëshirat tona të pandërgjegjshme në maskim. Interpretimi i ëndrrave shënoi fillimin e psikoanalizës dhe libri në fjalë është një tekst interesant, që vuri në dukje talentin unik të Freud si shkrihtar dhe teoricien kërkues. Si e mendonte Freud fenë? Në studimin e tij titulluar "E ardhmja e një iluzioni", Freud shkroi se: "Feja është e krahasueshme me një neurozë të femërisë". Ndërsa te libri i tij i titulluar: "Moisiu dhe monoteizmi", që ishte një nga veprat e fundit para vdekjes së tij, ai sugjeroi që të pranonim se: "Feja është një përpjekje për të marrë kontrollin mbi botën shqisore, në të cilën ne jemi vendosur, me anë të botës së dëshirës dhe të cilën ne kemi zhvilluar brenda nesh si rezultat i nevojave biologjike dhe psikologjike. Nëse dikush përpigjet t'i caktojë fesë vendin e vet në evolucionin e njeriut, ajo duhet parë si një paralele me neurozën që individit i civilizuar duhet të kalojë në rrugën e tij që nga femëria deri në maturim". Disa nga komentet e tij më kritikë mund të gjenden në tekstin e tij "Qytetërimi dhe pakënaqësitë e tij". "E gjithë gjëja është kaq e ëmbël, aq e huaj për realitetin, se për këdo që ka një qëndrim miqësor ndaj njerëzimit, është e dhimbshme të mendosh se shumica e njerëzve nuk do të mund të ngrihen mbi këtë pikëpamje të jetës", sugjeroi ai.

Gustave Le Bon, një tjetër emër i kohës tronditi me librin e tij, "Mbi psikologjinë e Turmës". Shqetësimi tij ishte nëse arsyeja dhe njerë-



zimi mund të bashkëjetonin në shoqërinë e gjerë. Libri tij "Mbi psikologjinë e Turmës" përdorte mes librave të tjerë ende në ushtrinë amerikane. Charles-Marie Gustave Le Bon 7 maj 1841-13 dhjetor 1931 ishte një studiues francez shumëplanësh, fushat e tij të interesit përfshinin antropologjinë, psikologjinë, sociologjinë, mjekësinë, shpikje dhe fizikë. Qëllimi i këtij studimi është të shpjegonte se turmat nuk janë shumica e pjesëve të tyre individuale, por një entitet i ri psikologjik, karakteristikat e të cilave janë përcaktuar nga "pavetëdija" e turmës. Në të njëjtën kohë, ai krijoi teoritë e tij psikologjike dhe sociologjike, kryetërisht eksperimente në fizikë dhe botonte libra të popullarizuar mbi këtë temë, duke parashikuar ekuivalencën mes masës dhe energjisë dhe duke profetizuar epokën atomike. I injoruar ose trajtuar me keqdashje nga seksionet e strukturave akademike dhe shkencore franceze gjatë jetës së tij, nga politikat konservatore dhe reaktionare, Le Bon ishte kritik për demokracinë dhe socializmin. Punimet e Le Bonit kanë ndikim në personalitetet të tilla të ndryshme si Theodore Roosevelt dhe Benito Mussolini, Sigmund Freud dhe Jose Ortega y Gasset, Adolf Hitleri dhe Vladimir Lenini. Le Bon teorizoi se ky entitet i ri, pra "turma psikologjike", si edhe e emërtuar ai, e cila del nga trupëzimi i popullsisë së mbledhur jo vetëm që formon një strukturë të re, por gjithashtu krijon një "pavetëdije" kolektive. Ndërsa një grup njerëzish mëtonte Le Bon mbledhen së bashku dhe bashkohen për të formuar një turmë, ekziston një "ndikim magnetik i dhënë nga turma" që transformon sjelljen e çdo individit derisa të qeveriset nga "mendja e grupit". Ky model trajton turmën si një njësi në përbërjen e së cilës, bëhet rob çdo anëtar individual ndaj mendimeve, vlerave dhe besimeve të tyre; Siç thoshte Le Bon: "Një individ në një turmë është një kokërr e rërës mes kokërrave të tjera, ku vullneti është era që i ngre". Le Bon detajoi tri procese kyçe që krijojnë turmën psikologjike: i) Anonimitetin, ii) Përmbajtjen dhe iii) Ndikueshmëria. Anonimiteti u siguron individëve racional një ndjenjë të pathyeshmërisë dhe humbjen e përgjegjësisë personale. Individit kështu bëhet primitiv, i paarsyeshëm dhe emocional. Kjo mungesë e vetëkontrollit i lejon individët t'i

"jepen instinktit" dhe të pranojnë disqet instinktive të "pavetëdijshmes". Për Le Bon, turma i ndërron vendin ligjit të evolucionit të Darvinit. Kontaminimi i referohet përhapjes në turmën e sjelljeve të veçanta dhe individët sakrifikojnë interesin e tyre personal për interesin kolektiv. Ndikueshmëria është mekanizmi përmes të cilit arrihet infeksioni; turma të bashkohet në një mendje të vetme, sugjerimet e bëra nga zërat e fortë në turmë krijojnë një hapësirë të tillë që ata të vijnë në krye dhe ta udhëheqin sjelljen e turmës. Në këtë fazë, turma psikologjike bëhet homogjene dhe e lakueshme ndaj sugjerimeve nga anëtarët më të fuqishëm të saj. "Udhëheqësit për të cilët flasim - thotë Le Bon, - zakonisht janë burra të veprimit sesa të fjalëve.

Ata nuk janë të talentuar me largpamësi të fortë... Ata janë rekrutuar posaçërisht nga radhët e atyre personave nervozë, gjysmë të çrregullt që janë në kufi me emërdinë". Një parashikim i tillë të habit dhe sot, është për këtë arsye që teoria e turmës së Le Bon end studiohet. Adolf Hitler është i njohur të ketë lexuar turmën dhe në Mein Kampf merret me teknikën propaganduese të propozuara nga Le Bon. Benito Musolini gjithashtu bëri një studim të kujdesshëm të Le Bon. Ai gjithashtu ndikoi Vladimir Leninin dhe bolshevikët. Luftës i duhen turmat dhe nacionalizmi manipulues që të shkojnë në luftë. David Emile Durkheim (15 prill 1858 - 15 nëntor 1917) ishte një sociolog francez. Ai formalizoi disiplinën akademike dhe bashkë me W. E. B. Du Bois, Karl Marxin dhe Max Weberin - përmendet zakonisht si arkitekti kryesor i shkencës shoqërore moderne. Pjesa më e madhe e punës së Durkheim kishin të bënte me mënyrën se si shoqëritë mund të ruanin integritetin dhe koherencën e tyre në periudhën e modernitetit, një epokë në të cilën lidhjet tradicionale shoqërore dhe fetare nuk janë më në drejtim sepse janë krijuar institucione të reja shoqërore. Puna e parë e madhe sociologjike titulluar "Ndarja e Punës në Shoqëri" u botua më 1893. Më 1895, ai botoi "Rregullat e Metodologjisë Sociologjike" dhe krijoi departamentin e parë evropian të sociologjisë, duke u bërë profesor i parë i sociologjisë në Francë. Në 1898, ai krijoi revistën L'Année Sociologique. Monografia Durkheim-it, Suicide (1897), një studim i sh-

kallës së vetëvrasjeve në popullatën katolike dhe protestante, shpreh fillimin e kërkimeve moderne sociale dhe shërbeu për të dalluar shkencën shoqërore nga psikologjia dhe filozofia politike. "Format fillestare të Jetës Fetare" (1912) paraqitën një teori të fesë, duke krahasuar jetën shoqërore dhe kulturore të shoqërive aborigjene dhe atyre moderne. Sociologu Emil Durkheim shqetësohej për humbjen e bashkësive të veçanta të qëndrueshme, ndërkohë që njerëzit transferoheshin në qytete e mëdha... Durkheim ishte gjithashtu thellësisht i preokupuar me pranimin e sociologjisë si një shkencë legjitime. Ai përsosi pozitivizmin e vendosur fillimisht nga Auguste Comte, duke promovuar atë që mund të konsiderohet si një formë e realizmit epistemologjik, si dhe përdorimin e modelit hipotetik-deduktiv në shkencat shoqërore. Për të, sociologjia ishte shkencë e institucioneve, nëse ky term vlerësohet në kuptimin e tij më të gjerë si "bindjet dhe mënyrat e sjelljes të krijuara nga kolektiviteti" dhe qëllimi i tij është të zbulojë faktet strukturore shoqërore. Durkheim ishte një përkrashës kryesor i "funktionalizmit struktural", një perspektivë themelore në të dyja shkencat sociologjike dhe antropologjike. Sipas mendimit të tij, shkencë shoqërore duhet të jetë thjesht holistike. E tillë është sociologjia dhe ajo do të duhet të studiojë fenomenet që i atribuohen shoqërisë në përgjithësi, sesa të kufizohet në veprimet specifike të individëve. Ai mbeti një forcë dominuese në jetën intelektuale franceze deri në vdekjen e tij në vitin 1917, duke prezantuar leksione të shumta dhe duke botuar vepra për tema të ndryshme, përfshirë sociologjinë e dijes, moralit, shtresëzimit social, fesë, ligjit, arsimit dhe devijimit. Terma të tillë Durkheimian si për shembull "ndërgjegjja kolektive" që nga ajo kohë hynë në leksikonin popullor.

Gjatë gjithë karrierës së tij, Durkheim ishte i shqetësuar kryesisht me tre objektiva: Së pari, krijimi i sociologjisë si një disiplinë e re akademike. Së dyti, për të analizuar se si shoqëritë mund të ruanin integritetin dhe koherencën e tyre në epokën moderne, kur gjëra të tilla si përkatësia fetare dhe etnike e përbashkët nuk mund të pranoheshin më si të vërteta. Për këtë qëllim ai shkroi shumë për efektin e ligjeve, fesë, arsimit dhe forcave të ngjashme mbi shoqërinë

dhe integrimin social. Së fundi, Durkheim ishte i shqetësuar me implikimet praktike të njohurive shkencore. Durkheim gjithashtu këmbënguli se shoqëria ishte më shumë se shumica e pjesëve të saj. Një tjetër element kyç për "teorinë e njohjes" së Durkheimit është koncepti i tij i përfaqësimeve kolektive, e cila është e përkrahur në studimin e tij për "Format Elementare të Jetës Fetare". Kolektivët e përfaqësimit" janë simbolet dhe imazhet që vijnë për të përfaqësuar idetë, besimet dhe vlerat e përpunuara nga një kolektivitet dhe nuk mund të reduktohen nga zgjedhësit individualë. Ato mund të përfshijnë fjalë, slogane, ide, apo ndonjë numër materialesh që mund të shërbejnë si simbol, si një kryq, një shkëmb, një tempull, një pendë etj. Siç shpjegon Durkheim, "kolektiviteti e përfaqësimit" krijohen përmes veprimit të ndërsjellë dhe janë produkte të aktivitetit kolektiv. Si të tilla, këto përfaqësime kanë aspektin e veçantë dhe disi kontradiktore që ato ekzistojnë jashtë nga individit (pasi ato krijohen dhe kontrollohen jo nga individit, por nga shoqëria në tërësi), por njëkohësisht brenda çdo individit të shoqërisë (nga virtyt i pjesëmarrjes së atij individit në shoqëri). Kaq ide dhe disiplina paraprind, por pse mendimi shkencor nuk tha lufta po vjen, ajo është në prag?! Do doja të parashtroja disa argumente hipotetike... Mbese duhen kuptuar simbolikat deduktive të mendimit shkencor, evolucionit dhe triumfit i më të fortit, turmat, kolektivimi përfaqësues, lufta për ekzistencë, pafuqia individuale, ato e pavetëdijshmja.

Mendimtarët, shpesh për të mos thënë gjithmonë, janë larg shtabëve ushtarake, apo kullisave ku flitet për interesa bankare, monetare e financiare. Edhe nëse ata e antipojnë atë që pritet të ndodhë si edhe është lufta, ata bllokohen ta parathënë... Mundet që atelieja e tyre e humlunitit nuk pengohet edhe gjatë luftës. Edhe sot ka mendimtarë e shkencëtarë... por edhe sot ka luftëra të pjesshme. Rasti jo human është kur me bindje shkencëtarit i vë idetë në shërbim të luftës, rralle por edhe ndodh... Keqinterpretimet e mendimit shkencor janë dhunim i shkencës nga propaganda, e cila shpie te lufta. Tek e fundit shtabet ushtarake, kreditë bankare para, gjatë dhe pas luftës, si dhe industria e armatimeve, kanë shumë më tepër besim në vendimarrje se mendimtarët e lirë, bota kujtohet për ta pasi lufta ka mbaruar. Veç duhet puar me zë të lartë se: "Lufta sjell viktima, ndërsa shkenca ushqen jetën dhe prosperitetin!" 100 vite pas Luftës së Parë Botërore, është e drejtë të mbajmë parasysh se: "Ndoshta, tragjedia përtej shkatërrimit, vuajtjes dhe dhembjes është siguria se do të vijë një luftë tjetër. Dhe një tjetër, dhe një tjetër. Edhe, kur konfliktet nuk quhen luftëra sipas ligjeve të kombeve, luftimet dhe vrasjet vazhdojnë. Pse? Sepse njeriu është mëkatardhe për dorë vullnetin e lirë për të zgjedhur luftën. Pashmangshmëria e njeriut që zgjedh të keqen që është çdo luftë i dha siguri shekullit të vazhdojë deri në ditët tona. Ai jep siguri për kohën që do të vijë. Do të ketë luftë"? Ky me sa duket është paganimi shpagues që e shoqëron njeriun në të gjitha kohërat. Mendimi do të duhet ta bëjë njeriun dhe vendimarrjen më të arsyeshme, kjo është sfida sa kohë që ende kudo luftohet dhe humben jetë njerëzore.

Ish-trajneri i Shqipërisë akuzon

Brigel: Guardiola ka shkatërruar futbollin gjerman

Guardiola ka lënë shenjë në futbollin gjerman, por sipas ish-trajnerit të Shqipërisë, Hans Peter Brigel, për keq. Trajneri spanjoll ka dy vite që është larguar nga Bajerni, por Brigel e bën përgjegjës për gjendjen aktuale të futbollit gjerman. "Është faji i tij,

sepse na ka krijuar iluzionin se duke mbajtur kontrollin e topit në 75% të ndeshjes, mund të fitosh. Por nuk është kështu, - ka thënë Brigel për 'Repubblica'. - Në futboll është rezultati më i rëndësishëm se

kontrolli i lojës. Të kesh kontrollin e topit nuk mjafton për të fituar, na e dha një shembull të mirë Franca, që doli kampione bote". Si mund të dalë Gjermania nga kjo krizë. Ja çfarë mendon Brigel: "Mund të fito-

het edhe duke u kthyer në një mënyrë më tradicionale loje. Nuk është gjëja më e rëndësishme loja e bukur, por ekuilibri në fushë. Mendoj se bëhet fjalë për një krizë tranzitore, që u ka ndodhur shumë ko-

mbëtareve në të kaluarën. Pas fitimit të Kupës së Konfederatave, mungoi kuraja për të ndryshuar. Duheshin lënë në shtëpi 4-5 lojtarë nga Botërori i 2014-ës, që nuk ishin më në gjendje të mirë dhe u duhej dhënë besim të rinjve, që fituan Kupën e Konfederatave".



Napoli refuzon ofertën "e çmendur" të klubit anglez

Skuadra e Mançester Junajtids prej kohësh është vendosur në kërkim të një mbrojtësi qendre dhe emri, që është përmendur së fundmi në "Old Trafford" është ai i Kulibalisë. Mbrojtësi afrikan është nominuar për çmimin e "BBC". "Lojtari afrikan i vitit" së bashku me mbrojtësin e Juventusit, Medhi Benatia. Megjithatë, sipas asaj që bën me dije "La Repubblica", skuadra e Napolit e ka refuzuar ofertën prej 90 milionë eurosh nga Junajtids për të marrë shërbimet e lojtarit.

Pritej shkakimi menjëherë pas humbjes turpërore me Skocinë. Italiani do "mbijetojë" edhe pak orë

Uells, ndeshja e fundit e Panuçit në krye të Shqipërisë

Presidenti Duka ka vendosur mbylljen e bashkëpunimit



Jeton Selimi

Kristian Panuçi është "de facto" i shkarkuar nga Shqipëria, ndonëse mungon e zeza mbi të bardhë, e cila do të zyrtarizonte dhe divorcin, që tashmë është i pashmangshëm. Një aventurë në krye të kuqezinjve që thuhet nuk u nis kurrë në të vërtetë, me teknikun që ndryshe nga paraardhësi i tij, De Biazit, i ka koleksionuar radhazi dështimet, të cilat i kanë kushtëzuar vendimin e presidentit Duka. Por, më shumë sesa humbjet, ajo që ka shqetësuar ka qenë Federatën Shqiptare të Futbollit ka qenë hendeku i pakapërcyeshëm mes trajnerit dhe lojtarëve. Një hendek që u krijua menjëherë pas miqësoreve ndaj Ukrainës dhe Kosovës dhe u shndërrua në abis në konferencën e fillimjavës së shkuar, ku Panuçi akuzoi publikisht lojtarët për mungesë impenjimi me fanellën e Kombëtares. Kjo gjendje u vërejt shumë mirë në fushën e lojës, ku në "Loro Boriçi" pamë një Kombëtare të shthurur, pa ide dhe që dukej haptazi se nuk e ndiqte trajnerin e saj. Në



të vërtetë, duhet thënë se edhe në rast fitoreje me Skocinë, kualifikimi nuk ishte i garantuar dhe pozicioni i Panuçit sërish mbetet në

diskutim. Presidenti Armando Duka ka menduar ta shkarkojë Panuçin që ditën e djeshme, por më pas e ka cilësuar të arsyeshme që ital-

iani të mbyllë dhe ndeshjen me Uellsin, për t'i lënë kohën e duhur përpilimit të kushteve të prishjes së kontratës. "Nuk kam pse tërhiqem. Nëse Duka nuk ka më besim tek unë, atëherë jam i gatshëm të ulemi dhe të bisedojmë", do të deklaronte Panuçi menjëherë pas humbjes 4-0 ndaj Skocisë, duke e bërë të qartë se nuk largohet nga Shqipëria pa marrë edhe një pjesë të kontratës së mbetur me vete. Italiani ka nënshkruar për një pagë prej 280 mijë euro në edicion, ndërsa deri më tani ka përfunduar gjysma e kohëzgjatjes së kontratës. Pra, janë në lojë edhe 140 mijë euro të tjera, shumë të cilën Duka dhe Panuçi pritet ta diskutojnë së bashku pas ndeshjes së të martës.

LIGA E KOMBEVE

Anglia mposht Kroacinë dhe shkon në "Final 4"

Anglia ka arritur të fitojë me përmbyse në takimin e fundit të Ligës së Kombeve kundër Kroacisë. Kjo ishte një sfidë, që do të vendoste kreun e grupit në Grupin 4 në Ligën A dhe Anglia arriti të marrë kreun. Edhe pse kroatët kaluan të parët në avantazh me anë të sulmuesit Kramariç, Anglia përmbysi gjithçka brenda 7 minutash. Në minutën e 78 ishte zëvendësuesi Lingard që barazoi takimin, pasi mori një pasim të mrekullueshëm nga Kejn. Ndërsa në minutën e 85 ishte vetë ylli Kejn që shënoi, duke i dhënë tri pikë të arta skuadrës së tij dhe kreun e grupit. Spanja e mbyll në vendin e dytë, në kuotën e gjashtë pikëve, ndërsa Kroacia mbetet e fundit me vetëm 4 pikë.

Mbrojtësi vijon të kërkojë ndjesë pas të kuqit


Mavraj: Ishte moment dobësie, mos vini në dyshim dashurinë për fanellën



mbëtares kam luajtur edhe i dëmtuar, madje në situata edhe shumë më të vështira, ndaj ajo që kërkoj është të më kritikoni sigurisht, por jo të vini në diskutim respektin dhe dashurinë për këtë fanellë e këto ngjyra. Shohim përpara, me bindje se Shqipëria do të kthejë kapitull. Të gjithë bashkë mund t'ia dalim përsëri, por nëse jemi të ndarë, atëherë mund të na mposhtë kushdo. Me respekt, Mërgim Mavraj".

Senegalezi i Liverpoolit

Tifozët e fyejnë, Mane del nga fusha duke qarë




Senegali fitoi 1-0 kundër Guineas, falë një autogoli të Mesa në fillim të pjesës së dytë. Një fitore e rëndësishme në kualifikueset për Kupën e Afrikës dhe ekipin e trajnerit Sise, ku nuk është se janë shumë të kënaqur. Më shumë se të gjithë, Sadio Mane, i cili në fund të ndeshjes doli nga fusha duke qarë. Sipas asaj që bën me dije "Sun", ylli i Liverpoolit ishte protagonist i një zëvendësimi të veçantë. Ai mbante duart në fytyrë për të fshehur lotët, më pas vuri fanellën në kokë. Lojtari nuk kishte pësuar asnjë dëmtim dhe motivi i lotëve të tij kishte të

bënte me sharjet, fyerjet dhe vërsëllimat nga tifozët e Senegalit. Mane humbi një rast shumë të mirë për të shënuar gjatë ndeshjes, duke shpërdoruar shansin për ta çuar rezultatin në 2-0. Një rast që për fatin e tij të keq dhe të skuadrës bëri që tifozët të reagonin keq në shkallët e stadiumit, duke vërsëllyer lojtarët e vet. Në fund të ndeshjes, Mane nuk mundi ta mbante veten nga kjo situatë dhe duke dalë u rrëzua në fushë. Me ndihmën e stafit teknik dhe të shokëve, ai doli në një cep të fushës.

Mërgim Mavraj pas kartonit të kuq ditën e shtunë ndaj Skocisë, ka kërkuar falje publikisht në "Instagram" dhe "Facebook" përmes disa rreshtave. Dalja e tij me karton të kuq në minutën e 22-të i hapë rrugë fitores së thellë të ishullorëve, që më pas triumfuan me rezultatin 4-0. Kapitëni kërkoi ndjesë edhe pas ndeshjes, por u pa i tensionuar, teksa nuk mungoi debati live në televizion, me moderatoren Hygerta Sako, apo edhe ish-lojtarin e Kombëtares, Ervin Fakaj. "E ndjej të kërkoj publikisht falje për atë moment dobësie. Të gjithë gabojmë dhe këtë herë më ndodhi mua. Për Ko-

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Pupi regjisor.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
- Turner aktore.
- Fillojnë festat.
- Skuadër greke.
- Falen pa fe.
- U shkrua nga Gorkij.
- Një sterë për... model.
- Janë bisha.
- Parashtesë për dy.
- Demoni që persekutonte Sarën.
- Stacion i famshëm orbital.
- Mendes regjisor.
- Një rreth i ngushtë miqësor
- Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
- Këndohen në opera.
- Është lajm i vjetër.
- Sharif aktor.
- Martin i Norma Rae.

- Mund të jenë filmi.
- Një jepet për hartim.
- Ami i Maupassant.
- Fundi i Turandot.
- Hallit këngëtare.
- Neill i Jurassic park.
- Pineda e Garcia Lorca-s.
- Giorgio stilist

VERTIKAL

- Morissette këngëtare.
- Kilmer aktor.
- Heche aktore.
- Fillojnë tatëpjetën
- Është diapozitiv shumë i ndjeshëm.
- Mbyllin spitale.
- Në krye të masave.
- Bëjnë shirit me shi.
- Qe vajza e Tantalit.
- Janë më shumë se dëshira
- Ishte dekret i sulltanit.
- Qe mbreti i urtë i Pilos.
- Quinn aktor.
- Gasol i NBA.
- Fillojnë garën.
- Një pjesë e reformave.
- Është si biskotë.
- Mund të jetë karmelitan.
- Sjellin shi.
- Bel i Maupassant.
- Direk pa ekstreme.
- Gjysma e bimëve.
- Mbyllin një motor.
- Është bitum.
- Fara këngëtare.
- Hanks aktor
- Stiller aktor.
- Morrison rockstar.
- Fillojnë masat.
- Në krye të tabelës.
- Derisa janë në fund.
- Fund filmi.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Film i hitchock.
- Fillojnë premierën.
- Janë legjendat.
- Kush ka... ka zët.
- Thurman aktore.
- Një pjesë e testamentit
- Një pjesë e studimeve.
- Kështu është situata e tensionuar.
- Telefoni në kartëvizitë.
- Është ngasje.
- Në krye të autoriteteve.
- Mbyllin mbledhjen.
- Pason abetaren.
- Nisin nga kreu.
- Fillojnë aafirimin.
- Cocker këngëtar.
- Bartok kompozitor.
- Tiriac që qe tenist.
- Oxa këngëtare.

VERTIKAL


- Janë enigmatikë.
- Emri i Vivaldit.
- Rjedh në klepsidër.
- Incialet e Selleck aktor.
- Fillojnë rubrikën.
- Ishte babai i Prokinit dhe Filomelës.
- Vitet pa kufij.
- Mbyllin kanate.
- U shit për një pjatë thjerza.
- ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
- Moore aktore.
- Rocca aktore.
- Janë përmasa.
- Mbyllin krahun.
- Duhen ruajtur.
- Ishte Europa komuniste.
- Agjenci Kombëtare Lokale
- Berg kompozitor.
- Të parat në Amsterdam.
- Elsa këngëtare.
- Memoria në computer
- Me të nxjerrin trarë.
- Në mes të dhomës.
- Ekstreme kateli.
- Kufijtë e lutjes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4	5		9	6	2		8
7						2	9
3	2					1	6
		2	7	4		8	6
				5	1		3
	1		6	2			4
1	3		2				
			3				7
9	6			8		3	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	9	4	3	1	7	2	5	8
3	1	8	5	2	6	9	4	7
5	2	7	8	4	9	6	3	1
7	8	5	2	6	3	1	9	4
1	3	6	9	8	4	5	7	2
9	4	2	7	5	1	8	6	3
4	5	3	1	9	2	7	8	6
2	6	9	4	7	8	3	1	5
8	7	1	6	3	5	4	2	9

Argëtim filozofik

-Është e nevojshme që njeriu t'i afrohet gjithmonë e më shumë të mirës e të përpiqet të ruajë mendjen e tij nga ligësitë. Mendja e atij që bën vepra të mira me gjysmë zemre, në fakt, merr kënaqësi në të keqe.

-Dhuna është frut i dëshirës.

-Njëqind vite të jetës së një njeriu që nuk merr në konsideratë Ligjin Suprem, është e krahasueshëm vetëm me 1 ditë të jetës së atij që e respekton.

-Është e preferueshme të mos bëhet një vepër e bërë keq, sepse më pas do pendohemi. ----

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	11	18	3	10	18	2	1	15	20	E	P	O	S	M	P	L							
3	2	6	5	3	2	1	5		13	1	R	E	T	E	V	A	R	I	A	N	T			
21		4	3	5	6	2	1	5		5	10	5	E	L	I	T	E	N	I	S	T	E	T	
1		6	10	1	2	8	11	6	4	1	5		N	E	K	A	P	I	T	U	L	L	I	
2	13	7		2	1	5	1		1	2	8	11	K	D	M	I	Û	R	A	S	E	S		
	19	1	7	3	5	6		15	14		10	6	A	E	A	L	L	A	K	U	T	O	T	
13	3	5		2		5	6	11	1		1	5	T	K	A	M	A	T	E	I	N	O		
5	2					21		19	6	2	1	5	E	A	S	E	N	T	T	K	P			
1	5	7		6	2	8	5	10	8	6			V	A	R	E	N	T	I	R	A	N	I	
16	8	7	8	17	6	5		1	6		21	6	A	L	T	E	M	I	L	E	D			
6				15	8	5	1	5			18	3	10	R	O	J	E	T	K	E	N	D	E	T
4	3	18	8	7	6		18	6	4	6	7	1	I	N	E	S	P	A	I	N	R	I		

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Argëtim filozofik

Thënie të mençura

- Atë që bëjmë, më mirë ta bëjmë të rrëgullt (mirë), për të mos u penduar.
- Urrejtja nuk ndalet nga urrejtja, në asnjë kohë; urrejtja pushon nga dashuria: ky është ligji i përjetshëm.
- Kujdesi shpie në përjetshmëri, moskujdesi në vdekje; të kujdesshmit nuk vdesin kurrë, të pakujdesshmit janë si të vdekur.
- 14-Nëse doni të arrini ndriçimin, nuk duhet të studioni mësim të panurmëta.
- Thellohuni vetëm të njëra. Cila? Te dhembshuria e madhe. Kushdo që ka shumë dhembshuri, ka të gjitha cilësitë e Budës në pëllëmbën e dorës.

